REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 82-të i botimit Nr. 42 (827998) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 23 tetor 2026



FORCA AJRORE SHQIPTARE ZGJERON ANGAZHIMIN NË NATO
13 EFEKTIVË NISEN DREJT KOSOVËS PËR MISIONIN KFOR

» faqe 3



SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI - SH.T. Z. ERIC WENDT: FORCOHET PARTNERITETI STRATEGJIK SHQIPËRI-SHBA PËR MODERNIZIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA DHE SIGURINË KOLEKTIVE

Në fokus të takimit, mbështetja amerikane për modernizimin e Forcave të Armatosura, rritja e kapaciteteve operacionale dhe forcimi i sigurisë kombëtare e kolektive. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Sh.T. z. Eric Wendt, gjatë të cilit u vlerësua partneriteti...

faqe 4



ZËVENDËSMINISTRJA E MBROJTJES ZNJ. BLERINA ABRAZHDA NË QENDRËN MARSHALL: INDUSTRIA E MBROJTJES, THEMEL I LIRISË STRATEGJIKE

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, ishte folësja kryesore në kursin "Emerging Security Issues", të organizuar nga Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë "George C. Marshall", me seli në Garmisch-Partenkirchen të Gjermanisë, ku trajtoi rëndësinë strategjike të industrisë së mbrojtjes, kapaciteteve prodhuese dhe bashkëpunimit mes aleatëve të NATO-s. Sesioni...

faqe 3



KAPITEN I RANGUT III DANIEL ZENELI: DO TË ZGJIDHJA PËRSËRI DETIN, UNIFORMËN DHE JETËN E OFICERIT TË MARINËS

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Për ne admiruesit e detit, ai është një horizont i pafund, një hapësirë lirie dhe bukurie. Për oficerët e Marinës, ai është edhe një fushë përgjegjësie, ku profesionalizmi, guximi dhe vendimmarrja vihen në provë çdo ditë. Për kapitenin e rangut III Daniel Zeneli...

faqe 6

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dhe gjenerallejtënant Arben Kingji presin komandantin e ri të KFOR-it, Roberto Vergori

Shqipëria riafirmon mbështetjen për KFOR-in dhe angazhimin për sigurinë në Kosovë e rajon

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, **z. Ermal Nufi**, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura**, gjenerallejtënant Arben Kingji,** pritën në Tiranë Komandantin e ri të misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), **gjeneralmajor Roberto Vergori.**

Takimet u përqendruan në rëndësinë e misionit të KFOR-it për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe strukturave të NATO-s në funksion të paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë takimit me ministrin e Mbrojtjes, Ermal Nufi, u vlerësua roli i rëndësishëm që KFOR-i luan në krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të sigurt e të qëndrueshëm në Kosovë, në përputhje me mandatin e tij. Në këtë kuadër, ministri Nufi riafirmoi angazhimin e Shqipërisë për mbështetjen e vazhdueshme të misionit dhe përmbushjen me përgjegjësi të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

“Kontributi ynë i vazhdueshëm dhe i palëkundur në këtë mision dëshmon rëndësinë e veçantë që i kushtojmë mandatit dhe rolit të tij në promovimin e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë dhe në mbarë rajonin”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai i përcolli gjithashtu gjeneralmajor Vergorit urimet për sukses në përmbushjen e detyrës së tij të re në krye të KFOR-it, duke shprehur mbështetjen e Shqipërisë për misionin dhe objektivat e tij në shërbim të paqes dhe sigurisë.

Ndërkohë, në takimin me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, në fokus ishte bashkëpunimi ndërmjet Forcave të Armatosura shqiptare dhe misionit të NATO-s në Kosovë. U evidentua rëndësia e koordinimit me aleatët dhe e bashkëpunimit institucional e ushtarak për përmbushjen e objektivave të përbashkëta të sigurisë.

KFOR-i vijon të ketë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e një mjedisi të sigurt në Kosovë, ndërsa bashkëpunimi ndërmjet strukturave të NATO-s dhe vendeve aleate mbetet thelbësor për ruajtjen e stabilitetit në rajon.

Shqipëria, si anëtare e NATO-s dhe partnere e ngushtë e Kosovës, vijon të kontribuojë në përpjekjet e përbashkëta për sigurinë kolektive, duke riafirmuar përkushtimin e saj ndaj paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal. Takimet në Tiranë rikonfirmuan rëndësinë e marrëdhënieve të ngushta të Shqipërisë me NATO-n dhe angazhimin e saj të qëndrueshëm në mbështetje të misionit KFOR. Në kushtet kur siguria dhe bashkëpunimi mbeten faktorë përcaktues për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, koordinimi ndërmjet institucioneve shqiptare të mbrojtjes dhe strukturave të Aleancës përbën një element të rëndësishëm për forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.





Ndërrimi i kontingjenteve shqiptare në KFOR, Kontingjenti IX merr detyrën në Pejë

Në “Camp Village”, në Pejë të Kosovës, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të kontingjenteve të Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të angazhuara në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR).

Gjatë ceremonisë, Kontingjenti VIII i Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut (RKJ) përfundoi me nder misionin e tij katër mujor, ndërsa Kontingjenti IX i Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut (RKV) mori zyrtarisht detyrën, duke vijuar angazhimin e trupave shqiptare në mbështetje të paqes dhe sigurisë në Kosovë.

Ndërrimi i kontingjenteve shënon vijimësinë e kontributit të Forcave të Armatosura shqiptare në kuadër të misionit të KFOR-it, në përmbushje të angazhimeve të Shqipërisë si anëtare e NATO-s. Pjesëmarrja në këtë mision dëshmon përgjegjësinë dhe përkushtimin e efektivëve shqiptarë në mbështetje të sigurisë, stabilitetit dhe bashkëpunimit në rajon.

Forca Tokësore vijon të kontribuojë në operacionet e Aleancës, duke dëshmuar profesionalizëm, disiplinë dhe gatishmëri në përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Për çdo efektiv, përfaqësimi i Shqipërisë në misionet ndërkombëtare të NATO-s është një përgjegjësi e rëndësishme dhe një mundësi për të dëshmuar vlerat dhe aftësitë e ushtarakëve shqiptarë.

Përfundimi me sukses i detyrës nga Kontingjenti VIII dhe marrja e përgjegjësive nga Kontingjenti IX dëshmojnë vazhdimësinë e angazhimit të Forcës Tokësore në shërbim të paqes dhe sigurisë. Nën flamurin shqiptar, efektivët tanë vijojnë të përmbushin me dinjitet detyrat në kuadër të Aleancës, duke kontribuar në forcimin e sigurisë kolektive dhe të stabilitetit në Kosovë.







Zëvendësministrja e Mbrojtjes znj. Blerina Abrazhda në Qendrën Marshall: Industria e mbrojtjes, themel i lirisë strategjike

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, ishte folësja kryesore në kursin **“Emerging Security Issues”**, të organizuar nga Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë “George C. Marshall”, me seli në Garmisch-Partenkirchen të Gjermanisë, ku trajtoi rëndësinë strategjike të industrisë së mbrojtjes, kapaciteteve prodhuese dhe bashkëpunimit mes aleatëve të NATO-s.

Sesioni u zhvillua gjatë javës kushtuar bazës industriale të mbrojtjes, një fushë me rëndësi të veçantë për sigurinë kombëtare, qëndrueshmërinë e kapaciteteve ushtarake dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve aleate. Me përvojën e saj si ish-pjesëmarrëse në programet e Qendrës “Marshall” dhe me 15 vite përvojë në industrinë e mbrojtjes, zëvendësministrja Abrazhda solli në diskutim njohuritë profesionale dhe këndvështrimin e saj mbi sfidat që lidhen me zhvillimin e kësaj industrie, duke i ndërthurur ato me përgjegjësitë e saj aktuale në drejtimin e mbrojtjes shqiptare.

Gjatë sesionit, vëmendje e veçantë iu kushtua gjeopolitikës së industrisë së mbrojtjes, ndikimit të kapaciteteve prodhuese dhe varësive në zinxhirët e furnizimit, si dhe rolit të bashkëpunimit industrial në rritjen e aftësisë së shteteve dhe aleatëve të NATO-s për t’iu përgjigjur krizave të zgjatura dhe sfidave të sigurisë. Në këtë kontekst, zëvendësministrja Abrazhda theksoi rëndësinë e drejtpërdrejtë që ka baza industriale e mbrojtjes për autonominë strategjike të shteteve dhe për garantimin e sigurisë afatgjatë.

“Baza industriale e mbrojtjes është themeli i lirisë strategjike”, - theksoi ajo, duke përcjellë një mesazh që nënvizon lidhjen e ngushtë ndërmjet kapaciteteve industriale, zhvillimit teknologjik dhe aftësisë së një vendi për të përmbushur nevojat e veta të mbrojtjes. Përvoja e saj në industrinë evropiane dhe amerikane të mbrojtjes përbën një vlerë të rëndësishme në trajtimin e çështjeve që lidhin industrinë me politikat e sigurisë. Në kushtet e një mjedisi ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks, zhvillimi i kapaciteteve prodhuese, sigurimi i furnizimeve dhe forcimi i partneriteteve industriale janë elemente thelbësore për rritjen e qëndrueshmërisë së mbrojtjes. Për Shqipërinë, këto zhvillime përbëjnë fusha me rëndësi për forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe zgjerimin e bashkëpunimit me aleatët. Shkëmbimi i përvojave dhe pjesëmarrja në diskutime strategjike ndërkombëtare krijojnë mundësi për njohjen e praktikave bashkëkohore dhe për një qasje më të integruar ndaj sfidave të sigurisë. Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë “George C. Marshall”, institucion i përbashkët amerikano-gjerman, shërben si një platformë e rëndësishme për studimet e sigurisë, zhvillimin profesional dhe dialogun strategjik mbi sfidat bashkëkohore. Përmes kurseve dhe programeve të saj, ajo mbështet shkëmbimin e njohurive dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të vendeve partnere dhe aleate. Pjesëmarrja e zëvendësministres Blerina Abrazhda si folëse kryesore në këtë kurs përfaqëson një mundësi për të ndarë përvojën profesionale shqiptare në një forum ndërkombëtar të specializuar, duke sjellë në vëmendje rëndësinë e industrisë së mbrojtjes si një komponent thelbësor të sigurisë, gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë strategjike.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

FORCA AJRORE SHQIPTARE ZGJERON ANGAZHIMIN NË NATO, 13 EFEKTIVË NISEN DREJT KOSOVËS PËR MISIONIN KFOR

Nisja e kontingjentit të parë të helikopterëve nga Shqipëria drejt misionit të NATO-s në Kosovë shënon një hap të rëndësishëm për Forcën Ajrore dhe zgjerimin e kontributit të Forcave të Armatosura në operacionet ndërkombëtare. Në ceremoninë e përcjelljes në Bazën Ajrore të Farkës, u theksua profesionalizmi i efektivëve shqiptarë, përkushtimi ndaj Aleancës dhe rëndësia e veçantë e sigurisë së Kosovës për paqen dhe stabilitetin e rajonit.

Një mision i ri, një përgjegjësi e përbashkët

Në Bazën Ajrore të Farkës, ceremonia e përcjelljes së 13 efektivëve të Forcave të Armatosura shqiptare shënoi një moment me rëndësi për angazhimin e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare. Kontingjenti do t'i bashkohet misionit të NATO-s, KFOR, në Kosovë, në kuadër të detyrave që do të kryhen në bazën ushtarake amerikane "Bondsteel".

Ky angazhim përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm për Forcën Ajrore shqiptare, duke dëshmuar zgjerimin e rolit të saj dhe konsolidimin e kapaciteteve profesionale e operacionale të Forcave të Armatosura. Ai pasqyron gjithashtu vijimësinë e kontributit të Shqipërisë në përpjekjet e përbashkëta të Aleancës për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit. Në një mision ku profesionalizmi, koordinimi dhe përgjegjësia janë thelbësore, 13 efektivët shqiptarë do të përfaqësojnë jo vetëm aftësitë e tyre ushtarake, por edhe përkushtimin e vendit tonë ndaj detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në NATO.

Ceremonia e zhvilluar në Farkë ishte një moment vlerësimi për ushtarakët që nisen drejt detyrës, por edhe një dëshmi e rëndësisë që Forcat e Armatosura i kushtojnë përgatitjes, disiplinës dhe gatishmërisë për të përmbushur misionet në bashkëpunim me aleatët.

Ministri Nufi: Forca Ajrore po zgjeron rolin e saj në NATO

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, e cilësoi këtë angazhim si një tregues të profesionalizmit të ushtarakëve shqiptarë dhe të përgjegjësive që Shqipëria përmbush si anëtare e përkushtuar e NATO-s.

"Kontingjenti që përcjellim sot është pjesë e kësaj përpjekjeje. Ai dëshmon se Forca Ajrore po zgjeron rolin e saj dhe se Forcat tona të Armatosura po konsolidojnë kapacitetet për të përmbushur detyra gjithnjë e më të rëndësishme në kuadër të NATO-s", - u shpreh ministri Nufi. Ky vlerësim nënvizon rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve ushtarake, rritjes së përgatitjes profesionale dhe aftësisë për të vepruar në mjedise shumëkombëshe. Përfshirja në misionet e Aleancës kërkon standarde të larta, bashkërendim të vazhdueshëm dhe gatishmëri për të përmbushur detyra që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e përbashkëta të sigurisë.

Për Forcën Ajrore, ky angazhim përbën një mundësi të rëndësishme për të zgjeruar përvojën operacionale dhe për të dëshmuar aftësitë e saj në një strukturë shumëkombëshe. Për Forcat e Armatosura në tërësi, ai është pjesë e procesit të vazhdueshëm të modernizimit dhe përshtatjes me kërkesat e sigurisë kolektive.

Siguria e Kosovës, pjesë e stabilitetit të rajonit

Duke iu referuar rëndësisë së veçantë të misionit KFOR, ministri i Mbrojtjes theksoi lidhjen e ngushtë ndërmjet sigurisë së Kosovës dhe stabilitetit të Shqipërisë e të rajonit.

"Për Shqipërinë, ky mision ka një rëndësi të veçantë, jo vetëm për lidhjen vëllazërore dhe historike me Kosovën, por edhe sepse siguria dhe stabiliteti i Kosovës lidhen drejtpërdrejt me paqen dhe sigurinë e Shqipërisë dhe gjithë rajonit tonë", - u shpreh ai.

Në këtë këndvështrim, angazhimi i Shqipërisë në KFOR përfaqëson një përgjegjësi që shkon përtej pjesëmarrjes në një mision ushtarak. Ai lidhet me interesin e përbashkët për një mjedis të sigurt, me rëndësinë e parandalimit të tensioneve dhe me nevojën për të mbështetur përpjekjet që i shërbejnë paqes së qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor.

KFOR-i, si mision i udhëhequr nga NATO, ka një rol të rëndësishëm në mbështetjen e një mjedisi të sigurt në Kosovë, në përputhje me mandatin e tij. Pjesëmarrja



e efektivëve shqiptarë në këtë mision është shprehje e angazhimit të vendit tonë për të kontribuar në mënyrë konkrete në përpjekjet e përbashkëta të Aleancës. Për Shqipërinë, ky angazhim mbart edhe një dimension të veçantë njerëzor e historik. Lidhjet e ngushta me Kosovën e bëjnë paqen dhe stabilitetin e saj një çështje me rëndësi të drejtpërdrejtë kombëtare, ndërsa bashkëpunimi me aleatët ofron një kuadër të përbashkët për përmbushjen e objektivave të sigurisë.

Angazhimi në KFOR, pjesë e kontributit ndërkombëtar të Shqipërisë

Duke riafirmuar vijimësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në misionin e NATO-s në Kosovë, ministri Nufi theksoi se vendi ynë do të vijojë të përmbushë përgjegjësitë me seriozitet dhe në bashkëpunim të ngushtë me aleatët e partnerët.

"Në këtë kuadër, angazhimi ynë në KFOR mbetet i palëkundur! Ne jemi plotësisht të përkushtuar që të vijojmë të përmbushim përgjegjësitë tona me seriozitet, në bashkëpunim të ngushtë me aleatët dhe partnerët tanë, në shërbim të sigurisë së përbashkët", - deklaroi Ministri i Mbrojtjes. Ai vuri në dukje se kontributi i Shqipërisë për sigurinë ndërkombëtare nuk kufizohet vetëm në KFOR, por shtrihet edhe në operacionet dhe misionet e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kjo pjesëmarrje pasqyron orientimin e Shqipërisë drejt bashkëpunimit shumëpalësh dhe angazhimin për të kontribuar në përballimin e sfidave të sigurisë në mjedise të ndryshme ndërkombëtare. Përmes këtyre angazhimeve, Forcat e Armatosura shqiptare forcojnë përvojën e tyre, zhvillojnë ndërveprueshmërinë me strukturat partnere dhe kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta.

Në këtë proces, rëndësi të veçantë merr edhe përgatitja e efektivëve, të cilët duhet të jenë të gatshëm të veprojnë sipas standardeve të Aleancës dhe të përfaqësojnë me dinjitet institucionin ushtarak shqiptar në çdo detyrë që u besohet.

Një ceremoni me vëmendje te njerëzit dhe familjet e tyre

Në ceremoninë e përcjelljes në Bazën Ajrore të Farkës ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji; komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Voci; komandantë e drejtues të Forcave të Armatosura, si dhe familjarë të efektivëve që nisen për mision. Prania e drejtuesve të lartë ushtarakë dhe e familjarëve i dha ceremonisë një dimension institucional dhe njerëzor. Pas uniformës dhe detyrës qëndrojnë përgatitja, përkushtimi si dhe mbështetja e familjeve, të cilat janë pjesë e rëndësishme e rrugëtimit të çdo ushtaraku që shërben larg vendit. Për efektivët që nisen drejt Kosovës, ky angazhim është një detyrë profesionale, por edhe një përgjegjësi për të përfaqësuar Shqipërinë në një mision me rëndësi për sigurinë rajonale. Për familjet e tyre, nisja shoqërohet me krenarinë për shërbimin dhe me pritjen që misioni të përmbushet me sukses.

Nga Farka në shërbim të paqes

Nisja e këtij kontingjenti shënon një tjetër hap në vijimësinë e kontributit shqiptar në misionet ndërkombëtare. Zgjerimi i rolit të Forcës Ajrore dhe konsolidimi i kapaciteteve të Forcave të Armatosura tregojnë rëndësinë që Shqipëria i kushton përmbushjes së angazhimeve të saj në kuadër të NATO-s. Në një rajon ku siguria, dialogu dhe bashkëpunimi mbeten kushte të rëndësishme për zhvillimin dhe perspektivën evropiane, pjesëmarrja në KFOR është një shprehje konkrete e përgjegjësisë së përbashkët për ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit.

Nga Bazën Ajrore të Farkës drejt Kosovës, 13 efektivët shqiptarë nisen me një detyrë të qartë: të shërbejnë me profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim, duke kontribuar në misionin e Aleancës dhe duke përfaqësuar denjësisht Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Përtej nisjes së një kontingjenti, kjo ceremoni përcjell mesazhin se siguria ndërtohet përmes përgjegjësisë, përgatitjes dhe bashkëpunimit. Një angazhim që forcon rolin e Shqipërisë në NATO dhe mbështet përpjekjet e përbashkëta për një Kosovë të sigurt dhe një rajon më të qëndrueshëm.



SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji – Sh.T. z. Eric Wendt: Forcohet partneriteti strategjik Shqipëri–SHBA për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe sigurinë kolektive

Në fokus të takimit, mbështetja amerikane për modernizimin e Forcave të Armatosura, rritja e kapaciteteve operacionale dhe forcimi i sigurisë kombëtare e kolektive.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Sh.T. z. Eric Wendt, gjatë të cilit u vlerësua partneriteti strategjik mes dy vendeve dhe rëndësia e vijimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Takimi shërbeu si një mundësi për të riafirmuar marrëdhëniet e ngushta ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe për të vënë në pah rolin e mbështetjes amerikane në zhvillimin dhe modernizimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë takimit, gjenerallejtënant Kingji shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-së, si partner strategjik i Shqipërisë, veçanërisht në procesin e modernizimit të kapaciteteve operacionale dhe ushtarake. Kjo mbështetje përbën një element të rëndësishëm në forcimin e aftësive mbrojtëse të vendit dhe në përmirësimin e gatishmërisë së trupave për përmbushjen e detyrave në nivel kombëtar dhe në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Në këtë kontekst, modernizimi i Forcave të Armatosura dhe rritja e ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s mbeten prioritete me rëndësi për përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë si vend anëtar i Aleancës. Bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara kontribuon në zhvillimin e kapaciteteve, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e standardeve profesionale e operacionale.

Gjenerallejtënant Kingji theksoi gjithashtu angazhimin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh, me synim forcimin e sigurisë kombëtare dhe asaj kolektive. Ky angazhim pasqyron vullnetin për të vijuar koordinimin me partnerët strategjikë dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në përpjekjet e përbashkëta për përballimin e sfidave të sigurisë.

Marrëdhëniet Shqipëri–SHBA në fushën e mbrojtjes mbështeten në një partneritet të konsoliduar, të ndërtuar mbi interesa të përbashkëta, besim dhe angazhim për sigurinë euroatlantike. Në kushtet e një mjedisi ndërkombëtar që kërkon gatishmëri dhe bashkëpunim të vazhdueshëm, forcimi i këtyre marrëdhënieve mbetet i rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të Shqipërisë dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj në kuadër të NATO-s.





Takimi ndërmjet shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, dhe Ambasadorit amerikan, Eric Wendt, rikonfirmon rëndësinë që të dyja palët i kushtojnë vijimësisë së partneritetit strategjik dhe zgjerimit të bashkëpunimit në shërbim të një mjedisi më të sigurt dhe të qëndrueshëm.



Akademia e Forcave të Armatosura në Konferencën III Ndërkombëtare Ballkanike në Bullgari

Shqipëria propozohet si vendi pritës i edicionit të ardhshëm të konferencës në vitin 2027

Një delegacion i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), i kryesuar nga **Prof. Asoc. Dr. Etleva Smaçi**, mori pjesë në **Konferencën e III Ndërkombëtare Ballkanike,** me temë **"Strategic Challenges of Building National Resilience in Southeast Europe"** (Sfidat strategjike të ndërtimit të qëndrueshmërisë kombëtare në Evropën Juglindore), e zhvilluar në Borovets dhe Sofje, Bullgari.

Pjesëmarrja u realizua në kuadër të Planit të Bashkëpunimit Dypalësh dhe rrjetit rajonal SEEN-IMHSS, duke krijuar mundësi për shkëmbimin e përvojave akademike dhe profesionale, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë ushtarak në rajon.

Konferenca shërbeu si një platformë shkencore dhe akademike për diskutimin e sfidave strategjike që lidhen me sigurinë dhe qëndrueshmërinë kombëtare në Evropën Juglindore. Në fokus të diskutimeve ishin historia ushtarake dhe përgatitja e shtetit për luftë, format bashkëkohore të rezistencës dhe sigurisë kombëtare, bashkëpunimi civilo-ushtarak dhe rajonal, si dhe çështje që lidhen me sigurinë kibernetike, demilitarizimin dhe politikat e identitetit.

Këto tema marrin rëndësi të veçantë në kushtet e një mjedisi të ndryshueshëm strategjik, ku bashkëpunimi ndërinstitucional, përgatitja akademike dhe shkëmbimi i njohurive janë elementë të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale të sigurisë.

Shqipëria, në rolin e vendit pritës në vitin 2027

Një zhvillim me rëndësi për përfaqësimin akademik të Shqipërisë në këtë rrjet rajonal është propozimi që vendi ynë të mirëpresë edicionin e ardhshëm të konferencës, në vitin 2027.

Që prej tetorit 2025, Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e rrjetit rajonal SEEN-IMHSS. Propozimi për organizimin e konferencës së ardhshme përbën një mundësi për të promovuar ekspertizën shqiptare në fushën e studimeve të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe për të zgjeruar bashkëpunimin me institucionet akademike dhe ushtarake të vendeve të Evropës Juglindore.





Për Akademinë e Forcave të Armatosura, angazhimi në veprimtari të tilla ndërkombëtare kontribuon në shkëmbimin e përvojave, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe forcimin e lidhjeve profesionale me institucionet homologe. Njëkohësisht, ai mbështet përfshirjen aktive të Shqipërisë në diskutimet rajonale mbi sfidat e sigurisë, qëndrueshmërinë kombëtare dhe perspektivat e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Shqipëria në rrjedhën e historisë: Dialogu, paqja dhe bashkëpunimi si vlera të së ardhmes kombëtare

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

> Nga Skënderbeu te Shqipëria e sotme, një histori drejtuesish, sfidash dhe përgjegjësish. Një komb nuk bëhet më i fortë nga dhuna, por nga dialogu, paqja dhe aftësia për të bashkëpunuar.

Shqipëria është një vend me histori të lashtë, me njerëz që kanë ditur të qëndrojnë përballë pushtimeve, varfërisë, padrejtësive dhe sfidave të mëdha Shqiptarët kanë dëshmuar ndër shekuj se dinë të mbrojnë familjen, nderin, tokën dhe identitetin e tyre. Kanë ditur të sakrifikojnë për lirinë, të ringrihen pas fatkeqësive dhe të ruajnë shpresën edhe në kohët më të vështira.

Nga Skënderbeu tek themelimi i shtetit shqiptar: kur bashkimi bëhet domosdoshmëri

Në kujtesën historike të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu zë një vend të veçantë. Ai nuk ishte vetëm një prijës ushtarak i shekullit XV, por edhe simbol i qëndresës dhe i përpjekjes për të bashkuar forcat shqiptare përballë një rreziku të përbashkët. Kuvendi i Lezhës i vitit 1444 mbetet një dëshmi e rëndësishme e përpjekjes për të kapërcyer ndarjet dhe për të bashkuar principatat shqiptare rreth një qëllimi të përbashkët. Në një kohë kur interesat e veçanta mund t'i ndanin princat dhe familjet sunduese, nevoja për mbrojtjen e vendit kërkonte bashkëpunim. Historia nuk duhet romantizuar dhe as figurat historike nuk duhen shkëputur nga koha në të cilën jetuan. Por nga kjo periudhë mund të nxjerrim një mësim që mbetet i vlefshëm: kur një shoqëri përballet me sfida të mëdha, ***përçarja e dobëson, ndërsa bashkëpunimi i jep mundësi të ecë përpara.***

Shekuj më vonë, në kohën e Rilindjes Kombëtare, shqiptarët e kuptuan se liria dhe identiteti nuk mund të mbroheshin vetëm përmes kujtesës historike. Ato kërkonin arsim, gjuhë të shkruar, kulturë, organizim dhe përpjekje të përbashkët. Figura si **Naim Frashëri, Sami Frashëri, Abdyl Frashëri, Pashko Vasa** dhe shumë të tjerë kontribuuan në një proces që synonte të zgjonte vetëdijen kombëtare dhe të përgatiste rrugën drejt pavarësisë. Më 28 nëntor 1912, me **Ismail Qemalin** në krye, Shqipëria shpalli pavarësinë. Ky akt historik nuk ishte thjesht ndërrim i një statusi politik. Ishte përpjekja për të krijuar një shtet, për të vendosur themelet e institucioneve dhe për t'i dhënë popullit shqiptar mundësinë të përcaktonte vetë të ardhmen e tij. Por shpallja e pavarësisë nuk i zgjidhi menjëherë problemet e vendit. Shteti i ri u përball me vështirësi të mëdha, me ndërhyrje të jashtme, me paqëndrueshmëri politike dhe me mungesë të burimeve të nevojshme për zhvillim. Shqipëria duhej të ndërtohej pothuajse nga fillimi.

Më pas, në jetën politike shqiptare u shfaqën drejtues dhe figura të ndryshme, mes tyre Ahmet Zogu dhe Fan Noli, me ide, vizione dhe rrugë të ndryshme për organizimin e shtetit. Historia e tyre tregon se ndërtimi i institucioneve dhe përcaktimi i drejtimit të vendit kanë qenë gjithmonë çështje të vështira, të shoqëruara me debate dhe rivalitete. Asnjë periudhë historike nuk mund të kuptohet drejt nëse shndërrohet në një gjykim të thjeshtë bardhë e zi. Çdo epokë duhet parë në kontekstin e saj, me arritjet, kufizimet dhe pasojat që la pas. Por një përfundim mbetet i qartë: Shqipëria ka pasur nevojë vazhdimisht për institucione të qëndrueshme, për përgjegjësi shtetërore dhe për një vizion që shkon përtej interesit të çastit.

Një histori që na mëson se pushteti nuk është mbi qytetarin

Shekulli XX solli për shqiptarët ndryshime të mëdha. Luftërat, pushtimi i huaj, vendosja e regjimit komunist dhe izolimi i gjatë lanë pasoja të thella në shoqëri, në familje dhe në mënyrën se si qytetarët e kuptonin marrëdhënien e tyre me shtetin.

Periudha e diktaturës komuniste mbetet një kapitull i rëndësishëm dhe i dhimbshëm i historisë sonë. Ajo u karakterizua nga mungesa e pluralizmit politik, kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore, represioni dhe izolimi ndërkombëtar. Të kujtosh këtë periudhë nuk do të thotë të ushqesh urrejtjen mes shqiptarëve. Përkundrazi, do të thotë të kuptosh se çfarë ndodh kur pushteti përqendrohet, kur mendimi ndryshe trajtohet si kërcënim dhe kur frika zë vendin e lirisë.

Një shoqëri nuk mund të ndërtojë të ardhmen duke harruar vuajtjet e së kaluarës, por as duke i përdorur ato si armë për të mbajtur gjallë ndarjet. Kujtesa historike duhet të shërbejë si mësim, si thirrje për drejtësi dhe si garanci që gabimet të mos përsëriten.

Dhjetori i vitit 1990 hapi një kapitull të ri. Lëvizja studentore, kërkesat për liri dhe pluralizëm dhe mobilizimi qytetar i dhanë Shqipërisë mundësinë të niste rrugën drejt demokracisë. Zgjedhjet pluraliste të vitit 1991 dhe ndryshimet që pasuan shënuan një kthesë të rëndësishme në organizimin politik të vendit.

Megjithatë, kalimi nga një sistem në tjetrin nuk ishte i lehtë. Tranzicioni u shoqërua me kriza ekonomike, konflikte politike, vështirësi institucionale dhe plagë shoqërore. Ngjarjet e vitit 1997 treguan sa të rënda mund të bëhen pasojat kur institucionet humbasin besimin e qytetarëve dhe kur krizat nuk trajtohen në kohë.

Në dekadat e demokracisë, Shqipëria është drejtuar nga presidentë, kryeministra dhe shumica të ndryshme politike, të cilët kanë qenë pjesë e periudhave të ndryshme të qeverisjes, me programe, vendime dhe përgjegjësi që duhen vlerësuar sipas fakteve dhe rezultateve konkrete. Nuk është e nevojshme që të gjithë të mendojmë njësoj për këta drejtues. Në një shoqëri demokratike, vlerësimet ndryshojnë dhe debati është i domosdoshëm. *Por ka një vijë që askush nuk duhet ta kalojë:* ***kundërshtari politik nuk është armik i vendit, ndërsa kritika nuk duhet të kthehet në urrejtje dhe rivaliteti nuk duhet të përfundojë në dhunë.***

Demokracia nuk kërkon që qytetarët të heqin dorë nga bindjet e tyre. Ajo kërkon që bindjet të mbrohen me argumente, me votë, me ligj dhe me përgjegjësi.

SHQIPËRIA JONË: Përgjegjësia për të ardhmen, dialogu dhe bashkëpunimi si themele të zhvillimit kombëtar

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe forcimit të marrëdhënies ndërmjet shtetit dhe qytetarit. Shërbimi publik duhet të mbështetet te ligjshmëria, transparenca dhe profesionalizmi; e drejta duhet të garantohet mbi bazën e ligjit dhe jo të njohjeve personale; ndërsa përgjegjësia institucionale duhet të ruajë vazhdimësinë e saj, pavarësisht ndryshimeve në drejtimin e institucioneve.

Një shoqëri që ndërton nuk është një shoqëri pa kritika. Përkundrazi, ajo është një shoqëri që di ta përdorë kritikën si instrument përmirësimi, llogaridhënien si mekanizëm transparence dhe reformën si mundësi për të korrigjuar mangësitë. Institucionet e qëndrueshme nuk krijohen duke shmangur vështirësitë, por duke i trajtuar ato me profesionalizëm, maturi dhe vendosmëri.

Të rinjtë, ura që lidh të sotmen me të ardhmen

Çdo reflektim mbi zhvillimin e Shqipërisë mbetet i paplotë nëse nuk vendos në qendër brezin e ri. Të rinjtë janë bartësit e energjisë krijuese, të dijes dhe të ideve të reja, por edhe ata që do të përballen nesër me pasojat e vendimeve që merren sot. Pyetja që duhet të udhëheqë shoqërinë tonë nuk është vetëm çfarë kemi arritur deri më tani, por edhe çfarë kushtesh po krijojmë për ata që do të vijnë pas nesh. Një shoqëri e pjekur u përcjell brezave të rinj jo vetëm njohuritë dhe përvojën e saj, por edhe aftësinë për të bashkëjetuar me mendime të ndryshme. Kundërshtitë janë pjesë e natyrshme e jetës publike, por ato duhet të shërbejnë për të pasuruar debatin dhe për të përmirësuar vendimmarrjen, jo për të krijuar barriera të pakapërcyeshme mes njerëzve.

Krenaria kombëtare merr vlerë të veçantë kur shndërrohet në përpjekje për të përmirësuar realitetin. Të nderosh figurat e historisë sonë do të thotë edhe të ruash trashëgiminë që ato përfaqësojnë, të mësosh nga përvoja e së kaluarës dhe të kontribuosh për një Shqipëri ku brezat e rinj të kenë më shumë mundësi për të jetuar, punuar dhe krijuar.

Dialogu dhe bashkëpunimi, shenja të pjekurisë shoqërore

Në një shoqëri demokratike, dallimet në mendime dhe në këndvështrime janë të natyrshme. Ato pasqyrojnë lirinë e individit dhe larminë e interesave shoqërore. Sfida qëndron te mënyra se si këto dallime menaxhohen dhe nëse ato shndërrohen në burim zhvillimi apo në pengesë për bashkëpunimin. Dialogu është një nga mekanizmat më të rëndësishëm për të kapërcyer mosmarrëveshjet dhe për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme. Ai kërkon gatishmëri për të dëgjuar, respekt për argumentin dhe vullnet për të identifikuar pikat e përbashkëta, edhe kur qëndrimet fillestare janë të ndryshme. Bashkëpunimi nuk nënkupton heqjen dorë nga parimet dhe as shmangien e kritikës. Ai nënkupton aftësinë për të dalluar çështjet që kërkojnë debat nga ato që kërkojnë veprim të përbashkët. Në këtë kuptim, maturia shoqërore shfaqet kur kundërshtitë trajtohen brenda kornizave të ligjit dhe kur interesi publik bëhet pikë referimi për vendimmarrjen.

Institucionet, organizatat shoqërore, komunitetet profesionale dhe qytetarët kanë role të ndryshme, por të ndërthurura në procesin e zhvillimit. Secili kontribuon nga pozicioni i vet dhe secili ka përgjegjësinë të respektojë rregullat që mundësojnë bashkëjetesën demokratike. Përvoja e vendeve demokratike tregon rëndësinë e institucioneve funksionale, të kontrollit të ndërsjellë të pushteteve, të medias së lirë, të drejtësisë së pavarur dhe të pjesëmarrjes qytetare. Një debat i zhvilluar me maturi nuk e dobëson shoqërinë; përkundrazi, e ndihmon atë të kuptojë më mirë problemet dhe të gjejë rrugëdalje. Paqja, në këtë kuptim, nuk është thjesht mungesë e përplasjes. Ajo është një gjendje që ndërtohet përmes respektit, drejtësisë, sigurisë dhe besimit të ndërsjellë. Ajo kërkon që e drejta për të shprehur mendimin të shoqërohet me përgjegjësinë për të respektuar të drejtat e të tjerëve.

Përgjegjësia qytetare dhe vlera e paqes

Paqja nuk kërkon heshtje përballë problemeve dhe as pajtim të detyruar mes këndvështrimeve të ndryshme. Ajo kërkon që problemet të trajtohen përmes mjeteve demokratike, që kritika të mos shndërrohet në armiqësi dhe që asnjë mosmarrëveshje të mos e zëvendësojë arsyen me dhunën. Një klimë e tillë komunikimi është e rëndësishme jo vetëm për stabilitetin e brendshëm, por edhe për imazhin dhe besueshmërinë e Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Një shoqëri që kultivon dialogun, respekton institucionet dhe investon në bashkëpunim krijon kushte më të favorshme për zhvillim, partneritet dhe integrim.

Shqipëria ka interesa të përbashkëta që kërkojnë përkushtim afatgjatë, forcimin e shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik, përmirësimin e shërbimeve publike, mbrojtjen e mjedisit, rritjen e cilësisë së arsimit dhe krijimin e mundësive për brezat e rinj. Përparimi në këto fusha kërkon kontribut të vazhdueshëm dhe një vështrim që shkon përtej shqetësimeve të përditshme.

Një vizion i përbashkët për Shqipërinë e së nesërmes

Shqipëria e së ardhmes duhet të jetë një vend ku zhvillimi material ecën paralelisht me përparimin shoqëror, ku institucionet fitojnë besimin e qytetarëve përmes punës dhe transparencës dhe ku çdo individ ka mundësinë të kontribuojë sipas aftësive të veta. Ndërtimi i një shteti funksional është një proces që kërkon kohë, përkushtim dhe pjesëmarrje të gjerë. Ai nuk mund të mbështetet vetëm te pritshmëritë ndaj institucioneve, por as të realizohet pa përgjegjësinë e tyre. Është një marrëdhënie e ndërsjellë, ku qytetari kërkon llogari dhe kontribuon, ndërsa institucionet dëgjojnë, veprojnë dhe japin përgjigje. Në këtë proces, kujtesa historike duhet të mbetet burim reflektimi dhe identiteti, jo arsye për të riprodhuar ndarjet. E kaluara duhet njohur me seriozitet, kontributet duhen vlerësuar në kontekstin e tyre dhe përvojat duhen përdorur për të përmirësuar të tashmen. Vetëm kështu historia bëhet një urë drejt së ardhmes.

Shqipëria nuk ka nevojë që të gjithë qytetarët e saj të mendojnë njësoj. Ajo ka nevojë që dallimet të bashkëjetojnë brenda një kuadri të përbashkët respekti, përgjegjësie dhe përkushtimi ndaj vendit. Ka nevojë për njerëz që e kuptojnë se interesi publik është më i gjerë se interesi individual dhe se zhvillimi i qëndrueshëm kërkon kontributin e shumë brezave.

Le t'u përcjellim brezave të rinj një Shqipëri me më shumë mundësi dhe me një kulturë komunikimi që e vlerëson dialogun. Le të ruajmë atë që është ndërtuar me mund, të përmirësojmë atë që kërkon ndryshim dhe të krijojmë hapësira të reja për bashkëpunim.

Shqipëria jonë është një përgjegjësi e përbashkët dhe një shpresë që duhet ushqyer çdo ditë. Forca e saj qëndron te njerëzit, te puna e ndershme, te institucionet e qëndrueshme dhe te aftësia për të ecur përpara me besim. Sepse një vend ndërtohet jo vetëm me atë që lë pas, por mbi të gjitha me vlerat që zgjedh të mbrojë dhe me të ardhmen që vendos të krijojë.

KAPITEN I RANGUT III DANIEL ZENELI: DO TË ZGJIDHJA PËRSËRI DETIN, UNIFORMËN DHE JETËN E OFICERIT TË MARINËS

Një jetë në shërbim të detit, një karrierë e ndërtuar mbi disiplinën dhe përgjegjësinë, një përvojë që merr vlerën e saj më të lartë në jetët e shpëtuara



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Për ne admiruesit e detit, ai është një horizont i pafund, një hapësirë lirie dhe bukurie. Për oficerët e Marinës, ai është edhe një fushë përgjegjësie, ku profesionalizmi, guximi dhe vendimmarrja vihen në provë çdo ditë. Për **kapitenin e rangut III Daniel Zeneli**, lidhja me detin ka nisur që në fëmijëri dhe është shndërruar në një zgjedhje jete, të përforcuar nga formimi në Akademinë e Marinës dhe nga vitet e shërbimit në Forcat e Armatosura.

Nga drejtimi i anijeve dhe angazhimi në operacionet e kërkim-shpëtimit, deri te pjesëmarrja në misionin e NATO-s në Detin Egje, në kuadër të SNMG2, rrugëtimi i tij profesional dëshmon përkushtimin e një ushtaraku që e sheh uniformën si përgjegjësi dhe shërbimin si detyrim ndaj jetës njerëzore. Gjatë këtij misioni, ai u vlerësua maksimalisht nga anija gjermane e komandës për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në rolin e koordinatorit.

Në këtë intervistë për gazetën **"Ushtria", kapiteni i rangut III Daniel Zeneli** rrëfen kujtimet e formimit ushtarak, sfidat e shërbimit në det, përgjegjësinë e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe përvojën në një mision ndërkombëtar, ku bashkëpunimi dhe përgatitja profesionale marrin një rëndësi të veçantë. Një rrëfim mbi një profesion që nisi si ëndërr fëmijërie dhe që, me kalimin e viteve, është shndërruar në një mision të përditshëm shërbimi.

Kapiten Zeneli, nëse do të ktheheshit pas në kohë, cili do të ishte kujtimi që do të veçonit nga fillimet e karrierës suaj ushtarake?

Një nga kujtimet më të bukura të jetës sime do të ishte momenti kur hyra në Akademinë e Marinës. I përkas brezit që e përfundoi këtë akademi në vitet 2000–2004 dhe e kujtoj atë periudhë me shumë nostalgji. Kalimi nga jeta civile në një mjedis ushtarak ishte një ndryshim i madh. Përballesha me një botë të re, të ndërtuar mbi disiplinën, rregullin, sakrificën dhe përgjegjësinë.

Megjithatë, për mua deti nuk ishte i panjohur. Që në fëmijëri kisha pasur një lidhje të veçantë me të dhe dëshiroja që edhe profesioni im i ardhshëm të lidhej me këtë hapësirë. Pranimi në Akademinë e Marinës ishte çasti kur një dëshirë e hershme nisi të merrte formë konkrete. Ishte një ndjenjë e veçantë, që edhe sot e ruaj me shumë krenari.

Çfarë ju mësoi Akademia e Marinës, përtej njohurive profesionale?

Akademia më dha bazat e formimit ushtarak, por edhe shumë më tepër se kaq. Aty mësova se disiplina nuk është thjesht respektimi i rregullave, por një mënyrë të menduari dhe të vepruari. Përgjegjësia nuk lidhet vetëm me detyrën që ke në dorë, por edhe me njerëzit që të besojnë dhe mbështeten te ti.

Formimi ushtarak të përgatit për situata që nuk mund të parashikohen gjithmonë. Të mëson të ruash qetësinë, të analizosh rrethanat dhe të marrësh vendime në kohën e duhur. Këto janë cilësi që fitohen përmes studimit, stërvitjes dhe përvojës, por edhe përmes përballjes me vështirësitë. Ato më kanë shoqëruar gjatë gjithë karrierës sime.

Gjatë viteve të shërbimit keni kryer detyra të ndryshme, përfshirë edhe atë të komandantit të anijes. Çfarë përfaqëson për ju kjo përgjegjësi?

Të jesh komandant anijeje do të thotë të mbash mbi vete një përgjegjësi të madhe, jo vetëm për përmbushjen e misionit, por edhe për sigurinë e ekuipazhit dhe për çdo vendim që merret gjatë lundrimit. Në det, profesionalizmi dhe përgatitja janë thelbësore, por po aq të rëndësishme janë besimi te njerëzit, komunikimi dhe aftësia për të vepruar si një ekip i vetëm.



Komandanti i Kompanisë së Mbështetjes së Shtabit, kapiteni i rangut III Daniel Zeneli

> **Të jesh komandant anijeje do të thotë të mbash mbi vete një përgjegjësi të madhe, jo vetëm për përmbushjen e misionit, por edhe për sigurinë e ekuipazhit dhe për çdo vendim që merret gjatë lundrimit. Në det, profesionalizmi dhe përgatitja janë thelbësore, por po aq të rëndësishme janë besimi te njerëzit, komunikimi dhe aftësia për të vepruar si një ekip i vetëm.**

Gjatë karrierës sime jam përpjekur të jap maksimumin në çdo detyrë që më është besuar. Çdo pozicion ka veçoritë dhe përgjegjësitë e veta, por në thelb mbetet i njëjti parim: ta kryesh detyrën me përkushtim dhe të jesh i vetëdijshëm për rëndësinë e uniformës që mban.

Ju i kushtoni një vend të veçantë operacioneve të kërkim-shpëtimit. Çfarë përjeton një ushtarak në çastet kur merr sinjalin se një jetë njerëzore është në rrezik?

Operacionet e kërkim-shpëtimit janë ndër përvojat më domethënëse të shërbimit tim. Në ato çaste, gjithçka merr një kuptim tjetër. Nuk mendon për lodhjen, për vështirësitë apo për kushtet atmosferike. Mendon se dikush ndodhet në rrezik dhe se ke detyrimin të bësh gjithçka që është e mundur për ta ndihmuar.

Këto operacione kërkojnë përgatitje të lartë, koordinim, vendimmarrje të shpejtë dhe besim të plotë te ekuipazhi. Çdo



pjesëtar duhet ta njohë rolin e vet dhe të veprojë me saktësi, sepse koha është faktor vendimtar. Për mua, krenaria më e madhe është të dish se, përmes detyrës dhe profesionalizmit tënd, ke mundur t'i gjendesh pranë një njeriu në çastin më të vështirë.

Kapiten Zeneli, një nga përvojat tuaja të rëndësishme profesionale ishte misioni në Detin Egje, në kuadër të SNMG2 të NATO-s. Si e kujtoni atë angazhim?

E kujtoj si një përvojë intensive, me sfida të shumta profesionale dhe njerëzore. Deti Egje, kushtet e ndryshueshme atmosferike dhe kompleksiteti i misionit kërkonin vigjilencë të vazhdueshme, gatishmëri dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet strukturave pjesëmarrëse.



Pjesëmarrja në një mision të NATO-s të jep mundësinë të përballesh me standarde të larta operacionale dhe të punosh në një mjedis shumëkombësh, ku komunikimi dhe koordinimi janë vendimtarë. Përvoja të tilla të ndihmojnë të kuptosh edhe më mirë rëndësinë e ndërveprueshmërisë, të përgatitjes dhe të besimit ndërmjet aleatëve.

Për mua, ky mision mbetet një nga kapitujt më të rëndësishëm të karrierës, jo vetëm për sfidat që përballuam, por edhe për përvojën që fituam si ushtarakë shqiptarë në një angazhim ndërkombëtar.

Gjatë këtij misioni, ju jeni vlerësuar maksimalisht nga anija gjermane e komandës për përkushtimin tuaj si koordinator. Çfarë përfaqëson ky vlerësim për ju?

E konsideroj një vlerësim të rëndësishëm, sepse lidhet drejtpërdrejt me punën, përkushtimin dhe përgjegjësinë e treguar gjatë misionit. Në një angazhim shumëkombësh, ku çdo veprim duhet të jetë i koordinuar dhe çdo informacion të përcillet me saktësi, roli i koordinatorit kërkon vëmendje, komunikim të vazhdueshëm dhe aftësi për të bashkërenduar punën me strukturat e tjera.

Vlerësimi nga anija gjermane e komandës ishte një motivim profesional, por edhe një dëshmi e rëndësisë së punës në ekip. Asnjë rezultat i arritur në det nuk është meritë e një personi të vetëm. Pas tij qëndrojnë përgatitja e ekuipazhit, bashkëpunimi dhe përkushtimi i të gjithë atyre që punojnë për përmbushjen e misionit.

Për mua, ky vlerësim është një përgjegjësi më shumë për të ruajtur të njëjtin standard profesional edhe në detyrat e ardhshme.

Çfarë ju mësoi puna në një mjedis shumëkombësh për bashkëpunimin ndërmjet forcave detare aleate?

Më mësoi se bashkëpunimi nuk ndërtohet vetëm mbi procedurat dhe detyrat e përcaktuara, por edhe mbi besimin, respektin profesional dhe aftësinë për të komunikuar qartë. Në operacionet shumëkombëshe, pjesëmarrësit mund të kenë përvoja dhe mënyra të ndryshme pune, por qëllimi është i përbashkët dhe kërkon një standard të unifikuar veprimi.

Njohja e procedurave, shkëmbimi i informacionit dhe koordinimi në kohë janë thelbësore për suksesin e misionit. Këto përvoja kanë vlerë edhe pas përfundimit të angazhimit, sepse njohuritë dhe praktikat e fituara mund të zbatohen në përgatitjen e mëtejshme të personelit dhe në rritjen e kapaciteteve të Forcave tona Detare.

Pas gjithë këtyre viteve në uniformë, si ka ndryshuar këndvështrimi juaj për profesionin e oficerit të Marinës?

Me kalimin e viteve, kupton se të jesh oficer marine nuk do të thotë vetëm të njohësh anijen, detin apo procedurat e lundrimit. Do të thotë të jesh i përgatitur për të marrë përgjegjësi, të udhëheqësh njerëzit dhe të përballosh situata të vështira pa humbur qetësinë dhe gjykimin profesional.

Në fillim, natyrshëm, të tërheqin emocionet e profesionit, mjedisi detar dhe sfidat e reja. Më pas, përvoja të mëson të vlerësosh më shumë përgjegjësinë që mbart çdo detyrë dhe rëndësinë e njerëzve me të cilët shërben. Uniforma merr kuptim të plotë përmes punës, përkushtimit dhe gatishmërisë për t'iu përgjigjur çdo situate.

Sot, për mua, krenaria nuk lidhet vetëm me detyrat e kryera, por edhe me përvojën e ndarë me kolegët dhe me kontributin që kemi dhënë në shërbim të njerëzve dhe të vendit.

Aktualisht mbani detyrën e Komandantit të Kompanisë së Mbështetjes së Shtabit. Sa e rëndësishme është kjo strukturë për funksionimin e përditshëm të një shtabi?

Mbështetja e shtabit është pjesë e rëndësishme e funksionimit të çdo strukture ushtarake, sepse krijon kushtet e nevojshme për përmbushjen e detyrave dhe për vijimësinë e veprimtarisë. Efektiviteti i një shtabi nuk varet vetëm nga planifikimi dhe vendimmarrja, por edhe nga organizimi, koordinimi dhe mbështetja që mundësojnë realizimin e tyre.

Në këtë detyrë, rëndësi të veçantë kanë përgjegjësia, korrektësia, organizimi dhe bashkëpunimi me strukturat e tjera. Çdo hallkë duhet ta kryejë funksionin e vet me përkushtim, sepse rezultati i përgjithshëm varet nga puna e koordinuar e të gjithëve. Pavarësisht ndryshimit të detyrave gjatë karrierës, parimi mbetet i njëjtë: të kontribuosh me profesionalizëm dhe të përmbushësh përgjegjësitë që të janë besuar.

Çfarë mesazhi do t'u përcillnit të rinjve që dëshirojnë të ndjekin karrierën e oficerit të Marinës?

Do t'u thosha të ndjekin atë që dëshirojnë me vendosmëri, por të jenë të vetëdijshëm se karriera ushtarake kërkon përkushtim, disiplinë, përgatitje dhe gatishmëri për sakrificë. Dashuria për detin është një pikënisje e bukur, por nuk mjafton e vetme. Ajo duhet të shoqërohet me studim, stërvitje, përgjegjësi dhe dëshirë të vazhdueshme për t'u përmirësuar.

Të rinjtë duhet të kuptojnë se uniforma nuk është vetëm simbol i një profesioni, por edhe shprehje e një detyrimi ndaj vendit dhe qytetarëve. Do të përballen me vështirësi, por pikërisht ato do t'i ndihmojnë të formohen profesionalisht dhe njerëzisht.

Në fund të këtij rrëfimi, nëse do t'ju jepej mundësia ta nisnit karrierën nga e para, a do të bënit të njëjtën zgjedhje?

Po, pa asnjë dyshim. Do të zgjidhja përsëri detin, uniformën dhe jetën e oficerit të Marinës. Kjo ka qenë ëndrra ime që në fëmijëri dhe, me kalimin e viteve, është bërë pjesë e pandashme e jetës sime.

Deti më ka mësuar të përballem me vështirësitë, ushtria më ka formuar me disiplinën dhe përgjegjësinë, ndërsa vitet e shërbimit më kanë bërë të kuptoj edhe më thellë vlerën e jetës njerëzore.

Jam krenar për detyrat që kam kryer, për ekuipazhet me të cilat kam shërbyer dhe për njerëzit të cilëve u kemi ardhur në ndihmë. Disa përvoja nuk maten me grada apo vlerësime, por me atë që lënë pas. Për mua, një nga dëshmitë më të çmuara të shërbimit është të dish se ke qenë pjesë e përpjekjeve për të shpëtuar jetë.

Prandaj, nëse do të kthehesha në fillim, do të bëja të njëjtën zgjedhje. Sepse për mua, të qenit oficer marine nuk ka qenë thjesht një profesion. Ka qenë ëndrra e fëmijërisë, rruga ime e jetës dhe një mision për të cilin ndihem krenar.

Et'hem Ramadan Ibrahimi, figura e boksit shqiptar dhe autor i veprave që ruajnë historinë e tij

Një veprimtari kushtuar historisë së boksit shqiptar, figurave të tij të shquara dhe kontributit të autorëve në ruajtjen e kujtesës sportive kombëtare

Më 17 tetor 2026, u zhvillua promovimi i librit të autorit Et'hem Ibrahimi **"Historia e Boksit Shqiptar IV"**, një veprimtari që mblodhi dashamirës të sportit shqiptar, veçanërisht të boksit, si dhe përfaqësues të shoqatave ushtarake "Skënderbegasit – Nderi i Kombit" dhe Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve të Shqipërisë (SHKURSH).

Takimi shërbeu jo vetëm si një mundësi për të prezantuar botime të reja, por edhe si një moment vlerësimi për njerëzit që kanë kontribuar ndër vite në zhvillimin e sportit, dokumentimin e historisë së tij dhe përcjelljen e përvojave te brezat e rinj.

Nëpërmjet kësaj vepre, autori sjell këndvështrime të ndryshme mbi historinë, zhvillimin dhe domethënien shoqërore të boksit. Kjo vepër do të kontribuojë në pasurimin e literaturës sportive shqiptare, duke ndihmuar në ruajtjen e kujtesës për sportistët, trajnerët dhe ngjarjet që kanë lënë gjurmë në këtë disiplinë.

Et'hem Ibrahimi, nga shkolla "Skënderbej" në historinë e boksit shqiptar

Një vend të veçantë në këtë veprimtari zuri vlerësimi për z. Et'hem Ibrahimi, emër i lidhur ngushtë me historinë e boksit shqiptar, si sportist, dëshmitar i zhvillimeve të këtij sporti dhe autor që i është përkushtuar dokumentimit të historisë së tij.

Rrugëtimi i Ibrahimit drejt sportit nisi në një moshë të re. Në vitin 1957, ai u largua nga Vlora dhe u vendos në Tiranë për të nisur studimet në shkollën e mesme ushtarake **"Skënderbej"**. Kjo shkollë, e njohur për disiplinën, edukimin dhe formimin e të rinjve, u bë një pikënisje e rëndësishme në jetën e tij.

I rregullt, i disiplinuar, fjalëpakë dhe punëtor, ai u dallua shpejt për seriozitetin dhe përkushtimin. Në mjedisin sportiv të shkollës pati mundësinë të njihej me disiplina të ndryshme, nën drejtimin e figurave të njohura të fizkulturës dhe sportit, ndër të cilët edhe Mjeshtri i Madh Ismet Bellova.

Ishte pikërisht syri i mprehtë i këtij mjeshtri që dalloi te Ibrahimi prirjet për boksin. Orientimi i tij drejt këtij sporti rezultoi vendimtar. Në vitin 1958, kur ishte në vitin e dytë të shkollës, ai u përzgjodh për të marrë pjesë në kampionatin e boksit dhe u dallua menjëherë për aftësitë e tij.

Kështu nisi një rrugëtim sportiv që do ta lidhte për shumë vite me ringun dhe me ekipin e njohur të Partizanit.

Sukseset në ring dhe roli i trajnerëve të mëdhenj

Karriera e Et'hem Ibrahimit u karakterizua nga përkushtimi, disiplina dhe rezultate të spikatura. Gjatë veprimtarisë së tij sportive, ai u shpall gjashtë herë kampion në nivele të ndryshme lokale, rajonale dhe kombëtare. Ndër sukseset e hershme përmenden edhe rezultatet e arritura në kampionatin e Garnizonit të Tiranës dhe në kampionatin e Shkodrës, në vitin 1959. Një prej veçorive që e dalloi ishte vazhdimësia e rezultateve në ring. Sipas të dhënave për karrierën e tij, për pesë vjet radhazi ai arriti të zinte vendin e parë në kategoritë e peshave mizë, këndes dhe pupël, përkatësisht 51, 54 dhe 57 kilogramë, duke dëshmuar aftësi, këmbëngulje dhe përgatitje të lartë sportive.

Megjithatë, Ibrahimi nuk e ka parë kurrë suksesin si meritë vetëm të vetes. Në kujtimet dhe vlerësimet e tij, ai ka nderuar vazhdimisht njerëzit që e ndihmuan të formohej si sportist dhe si njeri. Një vend të veçantë në këtë rrugëtim zë trajneri Ali Kastrati, të cilin Ibrahimi e kujton me respekt dhe mirënjohje. Për të,









Kastrati nuk ishte vetëm një trajner i aftë, por edhe një edukator, një njeri i afërt me sportistët, që i trajtonte ata me kujdesin e një prindi. Përkushtimi, përvoja dhe autoriteti i tij e bënë një figurë të pazëvendësueshme në historinë e boksit shqiptar.

Krahas Ismet Bellovës dhe Ali Kastratit, edhe mjedisi sportiv i Partizanit ndikoi në formimin dhe zhvillimin e Ibrahimit, duke e ndihmuar të ngjitej drejt niveleve më të larta të këtij sporti.

Një dëshmitar i një periudhe të vështirë për boksin shqiptar

Historia e z. Et'hem Ibrahimi është e lidhur edhe me një periudhë të vështirë të historisë së boksit në Shqipëri. Në vitet 1960, regjimi komunist ndërpreu zhvillimin zyrtar të këtij sporti, i cili u konsiderua i papërshtatshëm për shkak të karakterit të tij luftarak dhe u vu nën kufizime të rënda.

Për sportistët dhe trajnerët e kohës, kjo periudhë përbënte një goditje të rëndë për një disiplinë që kishte krijuar traditat, ekipet dhe brezat e saj. Kontrasti ndërmjet pasionit të sportistëve dhe kufizimeve të vendosura nga regjimi mbetet një kapitull domethënës i historisë së sportit shqiptar.

Ibrahimi është një prej njerëzve që e ka përjetuar nga afër këtë histori. Përvoja e tij personale, kujtimet për sportistët dhe trajnerët, si dhe njohja e drejtpërdrejtë e zhvillimeve të kohës, përbëjnë një burim me vlerë për të kuptuar jo vetëm historinë e boksit, por edhe marrëdhënien mes sportit dhe shoqërisë në periudha të ndryshme.

Nga përvoja sportive te dokumentimi i historisë

Pas viteve të kaluara në sport, z. Et'hem Ibrahimi e ka vijuar lidhjen me boksin edhe përmes shkrimeve, kërkimeve dhe dokumentimit historik. Libri i tij **"Historia e Boksit Shqiptar"**, i botuar në vitin 2023, shënoi një hap të rëndësishëm në përpjekjen për të mbledhur dhe sistemuar historinë e kësaj disipline në vendin tonë.

Vijimi i këtij angazhimi përmes botimit **"Historia e Boksit Shqiptar IV"** dëshmon përkushtimin e autorit ndaj ruajtjes së kujtesës sportive. Përvoja si ish-sportist, njohja me protagonistët e boksit dhe angazhimi i tij i mëvonshëm në jetën sportive i japin këtij dokumentimi një vlerë të veçantë.

Edhe sot, z. Ibrahimi vijon të mbetet i lidhur me veprimtaritë e boksit, duke kontribuar në komunitetin sportiv dhe duke u angazhuar si inspektor i ndeshjeve. Kjo vazhdimësi angazhimi tregon se lidhja e tij me ringun nuk ka qenë thjesht një etapë e jetës, por një pasion që e ka shoqëruar ndër vite.

Në këtë kuadër, puna e tij si autor përfaqëson një përpjekje për të mos lënë në harresë emrat, rezultatet, ngjarjet dhe përvojat që kanë ndërtuar historinë e boksit shqiptar.

Vlerësim për kontributin dhe mirënjohje për veprën

Gjatë veprimtarisë së 17 tetorit, kontributi i z. Et'hem Ibrahimi u vlerësua nga sekretari i Federatës Shqiptare të Boksit dhe nga miq e bashkëpunëtorë të tij, të cilët nënvizuan rëndësinë e angazhimit të tij të gjatë në këtë sport.

Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, sekretari i përgjithshëm i SHKURSH-it, z. Arben Mollaj, ftoi presidentin e shoqatës, z. Hamit Gojani, që t'i dorëzonte z. Ibrahim trofeun **"Nderi i Shoqatës"**. Ky vlerësim përbën një shenjë nderimi për rrugëtimin e tij sportiv dhe për përkushtimin në dokumentimin e historisë së boksit shqiptar.

Gjithashtu, në kuadër të vlerësimeve për figurën dhe kontributin e tij, z. Ethem Ibrahimi iu dorëzua edhe titulli **"Ambasador i Paqes"**, një tjetër vlerësim i përcjellë gjatë aktivitetit.

Këto vlerësime i dhanë veprimtarisë një dimension të veçantë, duke e kthyer promovimin e librave në një moment mirënjohjeje për një njeri që e ka lidhur jetën e tij me sportin, disiplinën, kujtesën historike dhe përcjelljen e përvojës te të tjerët.

Librat si urë lidhëse mes brezave

Botimet e tij e shohin sportin jo vetëm si garë dhe rezultat, por edhe si dukuri kulturore e shoqërore, që ndikohet nga institucionet, traditat dhe zhvillimet historike. Kjo qasje e zgjeron hapësirën e diskutimit mbi boksin, duke e vendosur atë në një kontekst më të gjerë të jetës shqiptare. Në tërësi, vepra e prezantuar dëshmon se historia sportive nuk ndërtohet vetëm nga rezultatet e regjistruara në tabela dhe nga titujt e fituar në ring. Ajo ndërtohet edhe nga kujtimet, përvojat njerëzore, puna e trajnerëve, sakrificat e sportistëve dhe përpjekjet e autorëve për t'i ruajtur këto vlera për të ardhmen.

Promovimi i librit të z. Et'hem Ibrahimi përbën, një veprimtari me rëndësi për komunitetin sportiv dhe për të gjithë ata që vlerësojnë historinë e sportit shqiptar. Ai shërbeu si një rast për të nderuar autorët, për të rikujtuar figurat e shquara të boksit dhe për të theksuar nevojën që përvoja e brezave të mëparshëm të dokumentohet e t'u përcillet brezave të rinj.

Ruajtja e historisë së boksit shqiptar është më shumë se një detyrë dokumentuese, është një mënyrë për të nderuar njerëzit që e ndërtuan këtë traditë dhe për të mbajtur gjallë vlerat e disiplinës, përkushtimit, respektit dhe qëndrueshmërisë. Në këtë mision, kontributi i Et'hem Ibrahimit përbën një pasuri për kujtesën sportive kombëtare.

Drejt një aleance strategjike euro-kanadeze në industrinë e mbrojtjes



KOLONEL (R) HYSNI GJERGJI
Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes



Marrëdhëniet ndërmjet Kanadasë dhe Bashkimit Evropian po hyjnë në një fazë që tejkalon formatin tradicional të partneritetit ndërmjet dy ekonomive perëndimore. Në një mjedis ndërkombëtar të karakterizuar nga rikthimi i konkurrencës ndërmjet fuqive, lufta në Ukrainë, rritja e kërcënimeve hibride dhe kibernetike, pasiguria e zinxhirëve globalë të furnizimit dhe rivlerësimi i varësive strategjike, Otava dhe Brukseli po ndërtojnë gradualisht një marrëdhënie që kombinon ekonominë, industrinë, teknologjinë dhe mbrojtjen.

Pika kryesore e kthesës ishte Samiti BE–Kanada i 23 qershorit 2025, gjatë të cilit u nënshkrua *Security and Defence Partner*ship – SDP. Marrëveshja krijoi një kornizë të strukturuar për bashkëpunim në industrinë e mbrojtjes, mobilitetin ushtarak, menaxhimin e krizave, sigurinë detare, kërcënimet hibride, sigurinë kibernetike, hapësirën, teknologjitë e reja dhe sigurinë ekonomike. Megjithatë, zhvillimet e vitit 2026, veçanërisht përfshirja e Kanadasë në mekanizmin *Security Action for Europe* – SAFE, tregojnë se bashkëpunimi po kalon nga deklaratat politike drejt mekanizmave financiarë, industrialë dhe operacionalë. Kjo e bën marrëdhënien Kanada–BE një nga modelet më interesante të transformimit të arkitekturës transatlantike të sigurisë. Themelet ekonomike të marrëdhënies Kanada–BE janë ndërtuar prej vitesh. Comprehensive Economic and Trade Agreement – CETA zbatohet përkohësisht që prej 21 shtatorit 2017 dhe ka krijuar një hapësirë të konsiderueshme ekonomike ndërmjet dy tregjeve.

Në vitin 2025, tregtia dypalëshe e mallrave dhe shërbimeve arriti rreth 130 miliardë euro, rreth 80% më shumë se në vitin 2016. Tregtia e mallrave arriti 81.5 miliardë euro, ndërsa shërbimet rreth 49 miliardë euro. Bashkimi Evropian mbetet partneri i dytë më i madh tregtar i Kanadasë pas Shteteve të Bashkuara. Por evolucioni aktual ndryshon nga logjika klasike e CETA-s. Çështja nuk është më vetëm liberalizimi i tregtisë. Konceptet e *economic security, strategic autonomy, resilience* dhe *de-risking,* po bëhen pjesë e politikës industriale. Në këtë mjedis, një minierë nikeli, një fabrikë municionesh, një prodhues gjysmëpërçuesish, një qendër të dhënash, një port apo një rrjet energjetik nuk vlerësohen vetëm nga rëndësia ekonomike. Ato konsiderohen gjithnjë e më shumë edhe elemente të sigurisë kombëtare.

Kanadaja është veçanërisht e rëndësishme për Evropën për shkak të kombinimit të saj të burimeve natyrore, kapaciteteve teknologjike, industrisë së avancuar, stabilitetit politik dhe përkatësisë në NATO. Në mars 2026, Kanadaja dhe Komisioni Evropian riafirmuan bashkëpunimin në fushën e lëndëve të para kritike dhe nevojën për zinxhirë furnizimi më të qëndrueshëm dhe të diversifikuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për mineralet kritike që përdoren në bateri, elektronikë, sisteme energjetike, hapësirë ajrore dhe sisteme ushtarake. Në këtë kuptim, siguria ekonomike po bëhet ura që lidh CETA-n me partneritetin e mbrojtjes.

Partneriteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes i vitit 2025 përcakton një spektër jashtëzakonisht të gjerë bashkëpunimi. Ai përfshin mbështetjen për Ukrainën, menaxhimin e krizave, mobilitetin ushtarak, sigurinë detare, hapësirën, sigurinë kibernetike, teknologjitë emergjente, kërcënimet hibride, reziliencën, mosproliferimin dhe sigurinë ekonomike. Kjo tregon një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si konceptohet mbrojtja. Në shekullin XX siguria transatlantike ndërtohej kryesisht mbi forcat e armatosura, bazat, armët dhe garancitë e NATO-s. Në mjedisin aktual, aftësia për të prodhuar municione, për të siguruar komponentë elektronikë, për të mbrojtur rrjetet energjetike, për të garantuar komunikimet satelitore dhe për të siguruar zinxhirët industrialë është po aq e rëndësishme sa numri i platformave luftarake.

NATO vazhdon të jetë organizata e mbrojtjes kolektive. Vetë dokumentet BE–Kanada nënvizojnë se NATO mbetet themeli i mbrojtjes kolektive për Kanadanë dhe shtetet e BE-së që janë anëtare të Aleancës. Por Bashkimi Evropian po merr një rol gjithnjë e më të madh në financimin, industrializimin dhe prodhimin e kapaciteteve të mbrojtjes. Këtu NATO dhe BE-ja fillojnë të plotësojnë njëra-tjetrën. NATO identifikon nevojat dhe objektivat e kapaciteteve; BE-ja krijon gjithnjë e më shumë mekanizma financiarë dhe industrialë për prodhimin e tyre. Vendimi i Samitit të NATO-s në Hagë, në vitin 2025, për orientimin drejt shpenzimeve prej 5% të PBB-së deri në vitin 2035, nga të cilat të paktën 3.5% për kërkesat kryesore të mbrojtjes, e shton ndjeshëm këtë dinamikë. NATO raportoi se aleatët evropianë dhe Kanadaja rritën së bashku shpenzimet bazë të mbrojtjes me afro 20% në terma realë gjatë vitit 2025. Kjo do të krijojë kërkesë afatgjatë për industri, teknologji, municione, sensorë, dronë, sisteme elektronike dhe infrastruktura ushtarake.

Zhvillimi më domethënës në marrëdhënien Kanada–BE është pjesëmarrja e Kanadasë në *Security Action for Europe* – SAFE. SAFE është instrument financiar i Bashkimit Evropian me një kapacitet deri në 150 miliardë euro hua afatgjata, i krijuar për të mbështetur investimet urgjente në mbrojtje, prokurimet e përbashkëta dhe zgjerimin e bazës industriale dhe teknologjike evropiane të mbrojtjes. Marrëveshja BE–Kanada u nënshkrua më 14 shkurt 2026 dhe u përfundua formalisht nga Këshilli më 15 qershor 2026. Kanadaja u bë vendi i parë joevropian që merr një akses të tillë në mekanizmin SAFE.

Fusha ku integrimi mund të ecë edhe më shpejt se industria tradicionale e mbrojtjes është teknologjia. BE-ja dhe Kanadaja krijuan "Digital Partnership" në nëntor 2023. Këtu krijohet lidhja direkte midis sigurisë civile dhe asaj ushtarake. Një sulm kibernetik ndaj një porti, rrjeti energjetik, kompanie telekomunikacioni, sateliti, banke apo fabrike municionesh mund të prodhojë pasoja strategjike pa përdorimin e armëve tradicionale. Për këtë arsye, ndarja klasike ndërmjet *cybersecurity* dhe *cyber defence* po bëhet gjithnjë e më pak e qartë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për industrinë e mbrojtjes. Fabrika ushtarake moderne nuk është vetëm objekt fizik. Ajo është një sistem i ndërlidhur ku prodhimi, rrjetet IT, sistemet operative industriale, furnizuesit dhe informacioni i klasifikuar formojnë një ekosistem të vetëm sigurie.

Në periudhën 2026–2028 faza kryesore do të jetë kalimi nga marrëveshjet politike te rezultatet konkrete industriale. Objektivi i BE-së është që të rrisë prokurimin e përbashkët dhe të zvogëlojë fragmentimin e tregut evropian të mbrojtjes. Sipas *Readiness Roadmap 2030*, synimi është që deri në fund të vitit 2027 të paktën 40% e prokurimeve të mbrojtjes të organizohen në format të përbashkët, ndërsa projektet dhe kontratat për boshllëqet kryesore të kapaciteteve duhet të jenë të vendosura deri në fund të vitit 2028. Në këtë fazë do të shihet nëse pjesëmarrja kanadeze do të shndërrohet në kontrata, prodhim dhe kapacitete reale. Njëkohësisht do të thellohet bashkëpunimi në minerale kritike, energji, AI, hapësirë dhe kibernetikë.

Në horizontin 2030–2035 mund të krijohet një hapësirë strategjike shumë më e integruar ndërmjet Kanadasë dhe Evropës. Ky model mund të përkufizohet si integrim strategjik pa integrim institucional të plotë. Në vend që Kanadaja të bëhet pjesë e institucioneve politike të BE-së, sektorët strategjikë të dy palëve bëhen gjithnjë e më të ndërvarur. Ky model gjithashtu krijon një formë të re të autonomisë strategjike perëndimore. Kanadaja redukton varësinë absolute nga tregu amerikan, ndërsa Evropa fiton akses në një partner të qëndrueshëm për burime, teknologji dhe industri.

Për Shqipërinë zhvillimi i SAFE ka rëndësi të drejtpërdrejtë siç e kam përshkruar në analizën time, të datës 18 shtator 2026, në gazetën "Ushtria". Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në BE dhe ka nënshkruar në dhjetor 2024 *Security and Defence Partnership* me Bashkimin Evropian. Komisioni Evropian vlerëson gjithashtu se vendi ka ruajtur nivel të lartë përputhjeje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Rregullat e SAFE lejojnë vendet kandidate dhe shtetet që kanë *Security and Defence Partnership* me BE-në, përfshirë Shqipërinë, të marrin pjesë në prokurime të përbashkëta sipas kushteve përkatëse. Megjithatë, huat SAFE u jepen shteteve anëtare të BE-së. Ky dallim është shumë i rëndësishëm. Për Shqipërinë, mundësia kryesore nuk duhet kërkuar vetëm në financim, por në hyrjen në zinxhirët industrialë të prokurimit evropian. Kanadaja ofron një precedent të rëndësishëm, ku një vend jashtë BE-së mund të krijojë mekanizma që e afrojnë industrinë e tij me sistemin evropian të mbrojtjes. Shqipëria ka avantazh shtesë sepse është njëkohësisht vend kandidat për BE dhe anëtar i NATO-s. Kjo krijon një mundësi për ta parë zhvillimin e industrisë shqiptare të mbrojtjes jo si një proces të izoluar kombëtar, por si pjesë të një rrjeti industrial euroatlantik.

Për Industrinë e Mbrojtjes, modeli kanadez ka vlerë jo sepse Shqipëria mund ta kopjojë atë në përmasa, por sepse tregon drejtimin në të cilin po transformohet industria moderne e mbrojtjes. Mësimi kryesor është se politika industriale e mbrojtjes nuk mund të ndahet më nga siguria ekonomike, teknologjia, kibernetika dhe zinxhirët e furnizimit. Në këtë kontekst, IM mund ta përdorë zhvillimin Kanada–BE si referencë për pesë drejtime prioritare: integrimin e industrisë shqiptare në zinxhirët evropianë të furnizimit, Përafrimin e standardeve të licencimit dhe mbikëqyrjes; Krijimin e hartës kombëtare të kapaciteteve industriale të mbrojtjes; Ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe *joint ventures*; Ndërtimin e një sistemi të posaçëm të sigurisë industriale, sepse sa më shumë industria shqiptare lidhet me zinxhirët evropianë të furnizimit, aq më shumë rriten kërkesat për mbrojtjen e informacionit, kontrollin e investimeve, *cyber security*, verifikimin e personelit dhe mbrojtjen ndaj ndërhyrjes së huaj. Ky dimension është veçanërisht i rëndësishëm. Integrimi në industrinë evropiane nuk sjell vetëm kontrata. Ai sjell edhe detyrime shumë më të larta sigurie. Prandaj roli i AIM duhet të evoluojë paralelisht me industrinë; nga një autoritet që licencon subjekte drejt një institucioni që kupton dhe mbikëqyr ekosistemin kombëtar të industrisë së mbrojtjes.

Shqipëria duhet ta trajtojë SAFE jo vetëm si instrument financiar të BE-së, por edhe si mekanizëm diplomacie industriale. Në vend që kompanitë shqiptare të presin vetëm kontrata kombëtare, objektivi afatmesëm duhet të jetë identifikimi i konsorciumeve dhe projekteve evropiane ku kapacitetet shqiptare mund të integrohen. Kjo kërkon koordinim midis Ministrisë së Mbrojtjes, AIM, Forcave të Armatosura, diplomacisë ekonomike dhe operatorëve privatë. Një fabrikë shqiptare që prodhon një produkt të izoluar për tregun kombëtar ka potencial të kufizuar.

Afrimi Kanada–BE nuk përfaqëson aktualisht një proces anëtarësimi të Kanadasë në Bashkimin Evropian. Ai përfaqëson diçka potencialisht më të rëndësishme për arkitekturën e ardhshme transatlantike, që është integrimi gradual i sigurisë, ekonomisë, teknologjisë dhe industrisë pa qenë e nevojshme një anëtarësi institucionale e plotë. *Security and Defence Partnership* krijoi arkitekturën strategjike. Si vend kandidat për në BE, anëtar i NATO-s dhe partner i BE-së në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, Shqipëria mund të pozicionohet gradualisht brenda ekosistemit të ri industrial evropian. Por kjo kërkon ndryshim të filozofisë. Objektivi nuk duhet të jetë thjesht "të ndërtojmë industri ushtarake në Shqipëri", por "të ndërtojmë industri shqiptare të mbrojtjes që është e aftë të integrohet në zinxhirët industrialë dhe teknologjikë euroatlantikë". Modeli Kanada–BE dëshmon se kufiri midis ekonomisë dhe mbrojtjes po zhduket gradualisht. Mineralet kritike, energjia, kibernetika, inteligjenca artificiale, industria dhe siguria ushtarake po bëhen elemente të së njëjtës strategji kombëtare. Pikërisht këtu duhet parë edhe perspektiva shqiptare, jo vetëm te fabrika apo produkti i veçantë, por te ndërtimi i një ekosistemi kombëtar të industrisë së mbrojtjes, të sigurt, të standardizuar dhe të integruar në Evropë.

KOLONEL SHKËLQIM ÇELA, një jetë në shërbim të Forcave të Armatosura

Nga njësitë komando dhe misionet ndërkombëtare te drejtimi i Komandës së Mbështetjes



NGA NËNKOLONEL (R) AGIM LIKA

Ka karriera ushtarake që mund të përmblidhen në disa rreshta të një biografie. Ka të tjera që kërkojnë të rrëfehen si pjesë e një historie më të gjerë: historia e një brezi oficerësh që e ndërtuan jetën e tyre profesionale mbi disiplinën, sakrificën, përgjegjësinë dhe shërbimin ndaj Atdheut.

Karriera e **Kolonel Shkëlqim Çelës** i përket kësaj kategorie. Ajo shtrihet në disa dekada të zhvillimit dhe transformimit të Forcave të Armatosura shqiptare dhe përfshin detyra të ndryshme, nga strukturat komando e inteligjenca ushtarake deri te drejtimi i burimeve njerëzore, planifikimi, operacionet, trajnimi dhe komandimi i strukturave të rëndësishme.

Në këtë rrugëtim, veçanërisht domethënëse janë edhe dy përvoja ndërkombëtare: pjesëmarrja në **Operacionin "Liria e Irakut" në vitin 2007** dhe në **misionin ISAF në Herat, Afganistan, në vitin 2013**. Ato nuk janë thjesht data në një jetëshkrim. Janë përvoja që e vendosën oficerin shqiptar në realitetin kompleks të operacioneve shumëkombëshe dhe i dhanë një dimension tjetër përvojës së tij profesionale. Por një karrierë ushtarake nuk ndërtohet vetëm në misione. Ajo ndërtohet çdo ditë: në stërvitje, në shtab, në komandë, në vendimmarrje, në përgjegjësinë ndaj njerëzve dhe në përmbushjen e misionit. Pikërisht për këtë arsye, ky botim nuk synon të jetë vetëm një renditje e detyrave të mbajtura. Ai synon të sjellë një **profil njerëzor dhe profesional**, duke evidentuar etapat kryesore të rrugëtimit të një oficeri karriere.

RRËNJËT E NJË RRUGËTIMI USHTARAK

Shkëlqim Çela lindi më **8 shkurt 1969, në Tiranë**. Brezi të cilit ai i përket, u formua në një periudhë të veçantë të historisë së vendit dhe të Forcave të Armatosura. Për një oficer të asaj kohe, zgjedhja e profesionit ushtarak nënkuptonte një jetë të organizuar rreth disiplinës, përgatitjes dhe përgjegjësisë. Rrugëtimi i tij profesional do të zhvillohej më pas në një periudhë transformimesh të mëdha për ushtrinë shqiptare. Nga strukturat dhe mentalitetet e një ushtrie të periudhës së mëparshme, Forcat e Armatosura do të hynin në një proces të gjatë reformimi, profesionalizimi dhe integrimi euroatlantik. Në këtë realitet ndryshues u zhvillua edhe karriera e Kolonel Çelës.

FORMIMI – THEMELI I PROFESIONALIZMIT

Një komandant i mirë nuk formohet vetëm në momentin kur merr komandën. Formimi i tij fillon shumë më herët.

Në vitin **1994**, Shkëlqim Çela kreu në Gjermani **Kursin e Gjuhës Gjermane**, **Kursin për Komandant Kompanie** dhe **Kursin e Parashutistit**.

Një vit më pas, në **1995**, ai përfundoi **kursin Komando në Tiranë**. Këto specializime përbëjnë një kapitull të rëndësishëm në formimin e tij. Përgatitja komando dhe ajo e parashutistit kërkojnë jo vetëm aftësi profesionale, por edhe qëndrueshmëri fizike e psikologjike, disiplinë, vetëkontroll dhe aftësi për të vepruar në kushte të vështira. Krahas formimit ushtarak, njohja e gjuhëve të huaja i dha atij një tjetër dimension profesional. Ai zotëron **anglishten në nivelin 3232** dhe **gjermanishten në nivelin 3333**. Në kushtet e një ushtrie që po ndërtonte gjithnjë e më shumë marrëdhënie bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, kjo përgatitje merr një rëndësi të veçantë.

NË RRUGËN E KOMANDËS

Karriera e Kolonel Çelës u zhvillua nëpër disa prej fushave më të rëndësishme të veprimtarisë ushtarake. Ai shërbeu si **Komandant i Batalionit Komando**, duke përjetuar drejtpërdrejt përgjegjësinë e komandimit të një strukture operacionale. Më pas, përvoja e tij u zgjerua në fushën e inteligjencës dhe planifikimit.

Gjatë viteve **2009–2011**, ai ishte **shef i Sektorit të Planifikimit në Departamentin e Inteligjencës të Shtabit të Përgjithshëm**. Në vitet **2011–2013**, shërbeu si **shef i Degës së Inteligjencës në Forcat Tokësore**. Këto detyra e vendosën përballë një dimensioni tjetër të profesionit ushtarak: aftësisë për të analizuar informacionin, për të planifikuar dhe për të mbështetur vendimmarrjen në nivele të ndryshme të komandimit.

IRAK 2007 – PËRVOJA E FUSHËS SË OPERACIONIT

Në vitin **2007**, Kolonel Shkëlqim Çela u angazhua për **gjashtë muaj në Operacionin "Liria e Irakut"**.

Misionet ndërkombëtare janë një nga provat më të rëndësishme të profesionalizmit ushtarak. Në një mjedis të tillë, oficeri nuk përfaqëson vetëm veten. Ai përfaqëson uniformën, strukturën dhe vendin nga vjen. Përvoja në Irak i dha atij



mundësinë të shërbente në një mjedis operacional ndërkombëtar dhe të përballej me kërkesat e një misioni ku koordinimi, disiplina dhe respektimi i procedurave kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për suksesin e detyrës. Gjashtë muaj në një teatër operacional janë një përvojë që nuk mund të përmblidhet vetëm me një rresht në CV. Ato mbeten pjesë e formimit profesional dhe njerëzor të çdo ushtaraku.

AFGANISTAN 2013 – HERATI DHE SFIDA E ISAF-it

Gjashtë vjet më vonë, në **2013**, erdhi një tjetër angazhim ndërkombëtar. Kolonel Çela shërbeu për **gjashtë muaj në misionin ISAF, në RC-W Herat, Afganistan**. Herati ishte një tjetër realitet operacional. Përvoja e fituar në Irak tashmë përballej me një tjetër mjedis, një tjetër strukturë operacionale dhe kërkesa të tjera. Pjesëmarrja në dy misione ndërkombëtare, në Irak dhe Afganistan, përbën një nga elementet më të rëndësishme të profilit të tij profesional.

Këto përvoja i dhanë mundësinë të shihte nga afër mënyrën se si funksionojnë strukturat shumëkombëshe, si ndërthuren kapacitetet e vendeve aleate dhe si zbatohet në terren ajo që planifikohet në nivelet e komandimit.

NGA OPERACIONET TE DREJTIMI INSTITUCIONAL

Pas përvojës së fituar në strukturat operacionale dhe në misionet ndërkombëtare, karriera e tij vijoi me detyra të rëndësishme drejtuese.

Në periudhën **2014–2015**, ai shërbeu si **Komandant i Qendrës së Përbashkët Operacionale**. Më pas, gjatë viteve **2015–2016**, ishte **Drejtor i Burimeve Njerëzore në Shtabin e Përgjithshëm**, ndërsa nga **2016 deri në 2018** mbajti detyrën e **Drejtorit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.** Ky është një ndryshim domethënës në profilin e përgjegjësive. Nëse komandimi i një njësie kërkon aftësi për të udhëhequr njerëzit në funksion të misionit, drejtimi i burimeve njerëzore kërkon të shohësh përtej njësisë dhe të kuptosh organizatën si një tërësi. Njeriu, në fund të fundit, mbetet kapaciteti themelor i çdo ushtrie.

KOMANDA E MBËSHTETJES – NGA SHTABI TE KOMANDA

Në vitet **2018–2020**, Kolonel Çela shërbeu si **Shef i Shtabit të Komandës së Mbështetjes**. Më pas 2022-2023, Komandant i Policisë Ushtarake.

Më pas, në vitet **2023–2024**, ai u emërua **Zëvendëskomandant dhe Komandant i Komandës së Mbështetjes**. Në vitin **2025**, mori përgjegjësinë si **Komandant i Komandës së Mbështetjes**. Kjo detyrë përfaqëson një pikë të rëndësishme të karrierës së tij. Nga viti 2025 dhe në vijim kryen detyrën e Zëvendëskomandantit të Komandës Mbështetëse. Përvoja e fituar në komandë, inteligjencë, planifikim, operacione, trajnim dhe burime njerëzore tashmë ndërthuret në një përgjegjësi të vetme drejtuese. Komanda nuk është vetëm autoritet. **Komanda është përgjegjësi.** Është përgjegjësi ndaj njerëzve, ndaj misionit, ndaj institucionit dhe ndaj Forcave të Armatosura.

NJË KARIERË, DISA DIMENSIONE

Duke parë në tërësi rrugëtimin profesional të Kolonel Shkëlqim Çelës, dallohen disa shtylla kryesore:

Komandimi - përvoja si Komandant i Batalionit Komando dhe në struktura të tjera drejtuese;

Inteligjenca dhe planifikimi - përvoja në Shtabin e Përgjithshëm dhe Forcat Tokësore;

Operacionet - përvoja në strukturat operacionale dhe dy misione ndërkombëtare.

Trajnimi - përgjegjësia për përgatitjen profesionale të personelit.

Burimet njerëzore - përvoja në Shtabin e Përgjithshëm dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Drejtimi - përgjegjësitë e marra në Komandën e Mbështetjes.

Këto dimensione nuk qëndrojnë të ndara. Ato krijojnë profilin e një oficeri që ka kaluar nëpër nivele dhe fusha të ndryshme të shërbimit ushtarak.

NGA OFICERI TEK KOMANDANTI

Ekziston një dallim mes të qenit oficer dhe të qenit komandant. Oficeri zbaton detyrën. Komandanti duhet të marrë përgjegjësinë për të tjerët. Kjo kërkon besim, vendimmarrje, disiplinë dhe aftësi për të krijuar një klimë ku njerëzit e kuptojnë misionin dhe përgjegjësinë e tyre. Rrugëtimi i gjatë i Kolonel Çelës në funksione të ndryshme ka krijuar një përvojë të shumanshme, ku komandimi në terren është plotësuar nga përvoja e shtabit dhe e drejtimit institucional. Ky kombinim përbën një nga vlerat kryesore të profilit të tij.

TRASHËGIMIA PROFESIONALE

Çdo oficer karriere lë pas vetes diçka më shumë se një listë detyrash. Lë njerëz që ka drejtuar. Lë kolegë me të cilët ka shërbyer. Lë vendime. Lë përvoja. Lë mësime. Dhe mbi të gjitha, lë një mënyrë të caktuar të konceptimit të detyrës.

Në rastin e Kolonel Shkëlqim Çelës, kjo trashëgimi profesionale lidhet me një karrierë të zhvilluar në shumë dimensione të shërbimit ushtarak dhe me përvojën e fituar si brenda vendit, ashtu edhe në misione ndërkombëtare.

SHËRBIMI QË NUK MATET ME VITET

Një uniformë mund të hiqet. Një detyrë mund të përfundojë. Një post mund t'i kalojë dikujt tjetër. Por përvoja e një oficeri mbetet. Ajo mbetet në kujtesën e njerëzve me të cilët ka shërbyer, në strukturat që ka drejtuar dhe në mësimet që u ka përcjellë brezave pasardhës. Rrugëtimi i Kolonel Shkëlqim Çelës është një shembull i një karriere të ndërtuar nëpër disa prej fushave themelore të profesionit ushtarak: **formim, komandim, inteligjencë, planifikim, operacione, misione ndërkombëtare, trajnim dhe drejtim institucional**.

Nga kursi Komando te misionet në Irak dhe Afganistan. Nga inteligjenca te planifikimi. Nga komandimi i njësive te drejtimi i burimeve njerëzore. Nga shtabi te Komanda e Mbështetjes. Një rrugëtim i tillë nuk është thjesht një kronologji detyrash. Është historia profesionale e një oficeri që ka kaluar nëpër etapa të ndryshme të jetës së Forcave të Armatosura dhe ka mbajtur përgjegjësi në nivele të ndryshme të saj.

Sepse karriera ushtarake nuk është vetëm një profesion. Është një mënyrë jetese, një përgjegjësi dhe një formë shërbimi ndaj Atdheut.

ANTIFASHISTËT SHQIPTARË NË LUFTËN E SPANJËS

75 vullnetarët shqiptarë që u rreshtuan në mbrojtje të lirisë, në 90-vjetorin e fillimit të Luftës Civile të Spanjës

Nëntëdhjetë vjet pas fillimit të Luftës Civile të Spanjës (1936–1939), historia rikthen në vëmendje një kapitull të veçantë të antifashizmit shqiptar: pjesëmarrjen e 75 vullnetarëve shqiptarë në Brigadat Ndërkombëtare, të cilët u bashkuan me luftëtarë nga dhjetëra vende të botës për të mbrojtur Republikën Spanjolle përballë forcave të gjeneralit Francisco Franco. Në një kohë kur Spanja ishte përfshirë nga një konflikt i përgjakshëm, këta shqiptarë morën një vendim që kapërcente kufijtë e atdheut të tyre. Ata u nisën drejt një vendi të largët, të motivuar nga bindjet antifashiste dhe idealet e lirisë, demokracisë e solidaritetit mes popujve. Për ta, lufta në Spanjë nuk ishte vetëm një përballje e brendshme politike, por edhe një betejë për të ardhmen e Evropës përballë përhapjes së fashizmit. Lufta Civile e Spanjës la pas rreth 500 mijë viktima dhe një shoqëri të rrënuar nga dhuna, represioni dhe përndjekjet politike. Në anën republikane luftuan rreth 35 000–40 000 vullnetarë të huaj, të organizuar në Brigadat Ndërkombëtare. Mes tyre, shqiptarët përbënin një grup të vogël në numër, por me një domethënie të veçantë në historinë e angazhimit antifashist të shqiptarëve.

Sot, kujtimi i tyre është më shumë se një akt nderimi

Është një thirrje për të mos harruar njerëzit që rrezikuan dhe sakrifikuan jetën për bindjet e tyre, në një nga konfliktet më përcaktuese të Evropës së shekullit XX. Historia e këtyre vullnetarëve meriton të dokumentohet, të studiohet dhe të përcillet te brezat e rinj si pjesë e kujtesës historike shqiptare.

Bijtë e kombit shqiptar që shkuan të vdisnin për lirinë e popullit spanjoll



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Tre vite më parë në organet e shtypit shqiptar publikova artikullin, "*Gjaku i antifashistëve shqiptarë në venat e Spanjës*", ndërkohë që 2026-ta korrespondon me vitin e 90-vjetorit të fillimit të Luftës së Spanjës. Shqiptarët janë rreshtuar në këtë rast në anën e duhur të historisë të Luftës së Spanjës dhe borxhi i kujtesës lidhet për këtë luftë pikërisht me kohën kur shqiptarët u nisën drejt frontit të antifashizmit. Ata shkuan në Spanjë me bindjen se po mbronin një popull tjetër, por në të vërtetë po luftonin edhe për të ardhmen e vendit të tyre, pasi një muaj pas rënies së Republikës spanjolle, fashizmi italian iu vërsul Shqipërisë për ta nënshtruar. Lufta e Spanjës, e zhvilluar nga viti 1936 deri më 1939, u bë fronti i parë i antifashizmit dhe ishte shumë më tepër se një konflikt i brendshëm spanjoll. Ajo u shndërrua në një përballje ndërkombëtare mes Republikës Spanjolle dhe forcave frankiste, të mbështetura fuqishëm nga Italia fashiste e Musolinit dhe Gjermania naziste e Hitlerit. Përballë tyre u rreshtuan mijëra vullnetarë nga vende të ndryshme të botës, të bindur se fashizmi duhej ndalur përpara se zjarri i tij të përhapej në të gjithë Europën. Në Brigadat Internacionale morën pjesë rreth 35 mijë antifashistë nga 53 vende të botës, ku nuk munguan edhe shqiptarët. Lufta e Spanjës u konsiderua një paralajmërim i madh për atë që do të vinte më pas. Në qiellin e Spanjës u provuan armë, taktika dhe mënyra të reja të luftës në tokë, në det dhe në ajër. Bombardimi i Guernicës, më 26 prill 1937, mbeti një nga simbolet më të forta të terrorit ajror që do të karakterizonte LIIB. Nën regjimin e mbretërisë shqiptare, autoritetet shqiptare vendosën censurë dhe masa të forta sigurie. Qeveria shqiptare njohu qeverinë e Frankos, ndërsa politika zyrtare ishte ajo e mos angazhimit. Por një pjesë e shqiptarëve mendonte ndryshe. Rreth 70 vullnetarë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova, Çamëria, Dibra, Shkodra, Korça, Elbasani, Përmeti, Kolonja, Puka, Mallakastra, Vlora e treva të tjera shqiptare, si dhe nga diaspora, morën rrugën drejt Spanjës. Nuk shkuan për pagesë dhe as për ndonjë shpërblim, shkuan me vullnetarizëm të plotë. Ata ishin "Vullnetarë të Lirisë", njerëz që kapërcyen kufijtë, kontrollet dhe rreziqet e kohës për t'u rreshtuar në krah të Republikës Spanjolle, që fashizmi kërkonte ta mbyste në gjak. Shqiptarët u përfshinë kryesisht në Brigadën XII "Garibaldi", ku veproi edhe kompania shqiptare e drejtuar nga kapiten Musa Fratari, por ata shërbyen edhe në formacione të tjera ndërkombëtare e spanjolle. Ishte një pjesëmarrje me një kuptim të veçantë për historinë shqiptare. Në një kohë kur fashizmi italian po i afrohej Shqipërisë, disa prej bijve të saj shkuan mijëra kilometra larg për ta luftuar atë në Spanjë.

Nga Madridi në Ebro, ku antifashistët shqiptarë që ranë për lirinë

Betejat e Spanjës ishin ndër më të përgjakshmet e kohës. Shqiptarët u gjendën në vijat e para dhe shumë prej tyre nuk u kthyen më. Kështu në Madrid ra Zef Pren Hoti nga Malësia e Shkodrës, Urfi Ali Agolli nga Dibra e Madhe, Teni Diamant Konomi nga Korça humbi jetën më 1 maj 1937, pasi anija me të cilën udhëtonte drejt Spanjës u godit nga avionët fashistë; Asim Vokshi nga Gjakova, oficer karriere, mori pjesë në Brigadën "Garibaldi" dhe ra në Fuente del Ebro më 4 tetor 1937. Në Spanjë ra Ramiz Varvarica nga Dibra, kapiten i Brigadës "Garibaldi", i cili u vra në frontin e Kaspes në vitin 1938; Musa Ali Kami, i njohur si Musa Fratari, nga Përmeti, ishte përgjegjës i një skuadre mitraljerësh dhe ra në betejat e famshme të Ebro-s. Në këto luftime u vranë apo u plagosën rëndë Xhemal Kada, Thimjo Nasho Gogozoto, Zihni Murat Çami, por dhe disa shqiptarë të tjerë përfunduan më pas në kampet naziste. Kosta Dhimitër Lito, i plagosur rëndë në frontin e Madridit, u mor nga Gestapoja dhe u zhduk në kampet e përqendrimit, major Ymer Puka u kap nga nazistët dhe u zhduk në një kamp gjerman. Janë 16 dëshmorë shqiptarë të lidhur me Luftën e Spanjës, ndërsa lista e emrave mbetet e hapur për kërkime e verifikime të mëtejshme, por nga ana tjetër ende nuk kemi eshtrat e dëshmorëve shqiptarë të rënë në Spanjë. Kjo është një nga dhimbjet më të mëdha të kësaj historie, për ata që ranë larg atdheut, në Madrid, Ebro, Aragonë, Katalonjë e në fronte të tjera, por në kujtesën shqiptare mbetën pjesë e historisë sonë kombëtare. Pesë prej tyre, Asim Vokshi, Xhemal Kada, Ramiz Varvarica, Musa Fratari dhe Veli Dedi, u shpallën Heronj të Popullit. Por për pjesën tjetër nuk ekziston ende një memorial i përbashkët që t'i mbledhë emrat e tyre në një vend të vetëm dhe t'ua përcjellë historinë brezave në qendër të vendit në Tiranë,



mungesë kjo që duhet korrigjuar dhe që t'ju flas brezave për këtë ngjarje të madhe ku shqiptarët dhanë kontribut si komb antifashist.

Kujtesa e aktit të madh të shqiptarizmës, një detyrim kombëtar

Lufta e Spanjës nuk është vetëm një kapitull i historisë europiane, por për Shqipërinë ajo është një dëshmi e hershme e qëndresës antifashiste dhe e solidaritetit ndërkombëtar të shqiptarëve. Vullnetarët shqiptarë shkuan në Spanjë përpara pushtimit të Shqipërisë, më 7 prill 1939, ndërkohë që disa prej tyre ishin ushtarakë të përgatitur në akademitë më prestigjioze europiane. Të tjerë ishin punëtorë, emigrantë, studentë e intelektualë. Mes tyre ishte edhe Justina Shkupi, e evidentuar si infermierja shqiptare pjesëmarrëse në këtë formacion, e njohur me Nënë Terezën. Ata lanë pas familjet dhe jetën e tyre për një kauzë që e konsideronin më të madhe se vetja. Disa u kthyen me plagë lufte, duke u përballur më vonë me burgje, internime dhe represion, të tjerë mbetën përgjithmonë në tokën spanjolle, ku një pjesë e eshtrave të tyre u zhdukën nga regjimi gjakatar i Frankos. Një dëshmi e rëndësishme e kësaj historie është edhe "Vullnetari i Lirisë", botim i shqiptarëve të Brigadave Internacionale në Madrid. Në vitin 1959 u botua libri "Lufta e Spanjës 1936-1939", i përgatitur nga vullnetarët shqiptarë dhe i redaktuar nga Petro Marko. Këto materiale përbëjnë një pasuri të rëndësishme dokumentare për të kuptuar atë që përjetuan shqiptarët në Spanjë. Prandaj kujtesa e tyre nuk duhet të mbetet vetëm në libra, arkiva dhe ceremonitë e rastit. Një grup intelektualësh, në kuadrin e 90-vjetorit të fillimit të kësaj lufte, propozojnë që Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim me institucionet e kujtesës, studiuesit, familjet e dëshmorëve, të ndërmarrë një nismë konkrete për ngritjen e një Memoriali të Antifashistëve Shqiptarë të Luftës së Spanjës në një nga lulishtet qendrore të Tiranës. Memoriali mund të jetë një vepër e thjeshtë dhe dinjitoze, me një element simbolik që lidhet me brigadat ndërkombëtare dhe me një pllakë përkujtimore ku të vendosen emrat e të 70 vullnetarëve shqiptarë si dhe 16 të rënëve antifashistë dëshmorë ndërkombëtarë. Në memorial duhet të vendoset edhe një kod që të mundësojë dhe të çojë në një arkiv digjital me biografitë, fotografitë, dokumentet, letrat dhe dëshmitë e tyre. Kështu monumenti nuk do të ishte vetëm një memorial përkujtimi, por një pikë e gjallë e edukimit historik, një tregues për të sotmen dhe të ardhmen. Po aq konkrete është edhe kërkesa e dytë: një rrugë në Tiranë të mbajë emrin "Rruga Dëshmorët Shqiptarë në Luftën e Spanjës". Ata ranë në dhe të huaj, por emrat e tyre u kthyen sikurse e meritojnë në historinë shqiptare me një mesazh të qartë për brezat sepse, liria mbrohet edhe atëherë kur rreziku duket larg vendit tënd. Lavdi 16 dëshmorëve shqiptarë të Luftës së Spanjës si dhe nderim për 70 vullnetarët antifashistë shqiptarë që ia zbardhën faqen Shqipërisë në sytë e opinionit ndërkombëtar! Lavdi bijve të shqiptarizmës që gjakun e derdhën nga Madridi te Ebroja, ku gjaku shqiptar vaditi tokën spanjolle në emër të antifashizmit.

Një nismë për të ruajtur kujtimin e vullnetarëve shqiptarë që luftuan dhe humbën jetën larg atdheut

Kanë kaluar nëntë dekada nga fillimi i Luftës Civile të Spanjës (1936–1939), por historia e shqiptarëve që morën pjesë në këtë konflikt vijon të meritojë më shumë vëmendje në kujtesën publike. Shumë prej tyre luftuan larg vendlindjes, ndërsa disa nuk u kthyen kurrë në atdhe. Sot, kur Shqipëria ka kaluar nëpër ndryshime të thella historike dhe shoqërore, lind natyrshëm pyetja: a nuk është koha që kryeqyteti të ketë një hapësirë të posaçme përkujtimore kushtuar vullnetarëve shqiptarë të Luftës së Spanjës?

Përkujtimi nuk kërkon që çdo aspekt i së kaluarës të interpretohet njësoj, por që faktet të ruhen, emrat të mos humbasin dhe kontributet njerëzore të trajtohen me seriozitet. Ndër figurat shqiptare të lidhura me Luftën e Spanjës përmendet **Asim Ali Vokshi**, i cili humbi jetën më 4 tetor 1937, gjatë luftimeve në Fuente del Ebro, në radhët e Brigadës "Garibaldi". Në kujtesën historike përmenden gjithashtu Zef Preng Hoti dhe Urfi Ali Agolli, të lidhur me luftimet për mbrojtjen e Madridit; Daut Muço Podgorani; si dhe Musa Ali Kami, i njohur si Fratari, dhe Thimjo Nasho Gogozoto, të cilët humbën jetën gjatë luftimeve në frontin e Ebro-s në vitin 1938. Një tjetër emër është Ramiz Varvarica, i cili ra më 6 prill 1938, në frontin e Kaspës.

Historia e Dhimitër Kostës, i njohur edhe si Kostë Dhimitri, nga Leskoviku, pasqyron një tjetër fat tragjik të lidhur me këtë periudhë. Pasi shërbeu në radhët e Brigadave Ndërkombëtare dhe u plagos rëndë në frontin e Madridit, ai u zhduk më vonë në kampet e përqendrimit në Gjermani gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas të dhënave biografike që kërkojnë dokumentim të mëtejshëm.

Këta emra përfaqësojnë vetëm një pjesë të historisë së vullnetarëve shqiptarë në Spanjë. Për këtë arsye, çdo nismë përkujtimore duhet të shoqërohet me kërkime të mëtejshme në arkiva, verifikim të të dhënave biografike dhe identifikim sa më të plotë të atyre që morën pjesë në konflikt dhe të atyre që humbën jetën.

Një shoqëri që kujdeset për kujtesën historike nuk nderon vetëm të kaluarën; ajo investon edhe në edukimin e brezave të ardhshëm. Nderimi i vullnetarëve shqiptarë të Luftës së Spanjës mund të bëhet një nismë e përbashkët qytetare dhe institucionale, përtej bindjeve politike dhe dallimeve ideologjike. Sepse kujtesa historike nuk është pronë e një partie apo e një periudhe të vetme. Ajo është pjesë e trashëgimisë së përbashkët dhe një përgjegjësi që u takon të gjithëve.

Teni Diamant Konomi, i cili humbi jetën më 1 maj 1937, në ujërat e Barcelonës, pasi vapori me të cilin udhëtonte drejt Spanjës u godit nga forcat fashiste. Konomi u vra pa arritur në tokën spanjolle. Xhemal Osman Kada, i cili u plagos rëndë më 28 shtator 1938 në Ebro, gjatë luftimeve, dhe vdiq si pasojë e plagëve të marra. Xhelal Abaz Bajrami (Çami), i cili u plagos rëndë disa herë në Ebro, më 1938. Sipas të dhënave të përmendura, ai vdiq më vonë në spital, si pasojë e plagëve të rënda. Zihni Murat Çami vdiq në tetor të vitit 1938 në Ebro. Të dhënat shkruajnë se ai u zhduk gjatë luftimeve dhe se trupi i tij nuk u gjet kurrë. Ndër luftëtarët e Luftës së Spanjës përmendim dhe Kosta Dhimitër Lito, i cili u plagos rëndë në Madrid dhe më pas përfundoi në kampet e përqendrimit, ku u zhduk, si dhe Nevruz Veliu, për fatin e të cilit përmenden të dhëna të ngjashme. Nga ana tjetër, Ymer Puka rezulton të ketë vdekur në vitin 1944, si pasojë e plagëve të luftës, në një kamp përqendrimi nazist në Francë. Emrush Myftari ishte pjesëmarrës në Luftën e Spanjës, por burimet e Petro Markos e rendisin ndër të mbijetuarit e luftës. Më vonë, ai u vra nga shërbimet jugosllave. Për këtë arsye, nuk konsiderohet i rënë në Luftën e Spanjës.

Ndërsa Mehmet Shehu nga Mallakastra (1910-1981), Veli Dedi nga Kosova, Ibrahim Kuzani nga Elbasani, Emin Agolli e Stivens Thanasi shqiptar nga SHBA, Qamil Sherifi shqiptar nga SHBA, mitraljer i plagosur në luftë; Feim Muço nga Gjirokastra, Iliaz Pashai nga Vlora (1908-1962), Justina Shkupi nga Shkupi, infermiere shqiptare e vetmja femër nga Shqipëria, Hulusi Spahiu nga Gjirokastra, Kosta Banaku Silla, Mane Abaz Nishova nga Skrapari, Nezir Isa Veshtina nga Çamëria, Qamil Çela nga Peqini, Petro Jani Marko nga Dhërmiu, Servet Abedin Veliu nga Çamëria, Skënder Petro Luarasi nga Kolonja (1900-1982), nga SHBA, Thoma Rushano nga arbëreshët e Italisë, Zef Nikë Prela nga Mirdita, i ardhur nga Çekosllovakia, plagosur rëndë, Sabri Luman Katundishta nga Përmeti, Nevrus Zagari nga Lubonja e Korçës, Xhafer Miraka nga Elbasani, Kapiten Myftari nga Kosova, Kostandin Vasil Note nga Malëshova e Përmetit (1911-1986), që dokumentohen si pjesëmarrës ose të mbijetuar, jo si pjesë e një liste të verifikuar plotësisht për luftën e Spanjës. Fakt është se burimet shqiptare flasin për 16 dëshmorë të Luftës së Spanjës, por listimi i plotë, me datën dhe vendin e rënies së secilit, nuk rezulton plotësisht i unifikuar në burimet e publikuara. Dokumentimi arkivor kërkon të dhëna të qëndrueshme dhe identifikuese, të mbështetura në burime serioze, për të gjithë luftëtarët shqiptarë të rënë ose të zhdukur në frontet e Luftës së Spanjës.

Kurora e një nëne, lavdia e një dëshmoreje: Marianthi Panariti në historinë e Korçës



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj



Jeta, qëndresa dhe flijimi i një nëne shqiptare për lirinë

Marianthi Panariti ishte një nga ato gra shqiptare që e shndërruan dashurinë për familjen, qytetin dhe atdheun në një qëndresë të guximshme kundër pushtuesve fashistë. Ajo nuk ishte vetëm një nënë që rriti dhe edukoi katër vajza, por edhe një veprimtare antifashiste, e cila mori pjesë në demonstratat popullore të Korçës dhe dha jetën për lirinë e vendit. Emri i saj mbetet i lidhur me një nga ngjarjet më tragjike të qëndresës antifashiste në këtë qytet.

Demonstrata e përgjakshme e Korçës

Në ditët e shtatorit 1943, pas kapitullimit të Italisë fashiste, qyteti i Korçës përjetoi një shpërthim të fuqishëm të ndjenjave antifashiste dhe atdhetare. Rrugët dhe rrugicat e tij u mbushën me qytetarë të të gjitha moshave, të cilët dolën për të shprehur kundërshtimin ndaj pushtimit dhe për t'u bërë thirrje ushtarëve italianë të dorëzonin armët e të bashkoheshin me popullin në luftën kundër pushtuesve gjermanë. Në këto demonstrata morën pjesë edhe shumë gra e vajza korçare. Prania e tyre dëshmonte se lufta për liri nuk ishte vetëm çështje e burrave që luftonin me armë, por edhe e grave që përballeshin me rrezikun në rrugët e qytetit, duke shprehur hapur bindjet e tyre atdhetare. Përballë kësaj lëvizjeje popullore, komanda e trupave italiane nuk iu përgjigj thirrjeve për bashkim kundër pushtuesve të rinj. Përkundrazi, urdhëroi hapjen e zjarrit mbi demonstruesit. Plumbat fashistë goditën njerëz të paarmatosur, duke shkaktuar viktima të shumta dhe duke e kthyer demonstratën në një tragjedi të rëndë për Korçën.

Sipas të dhënave të sjella në këtë rrëfim, në mesin e 59 të vrarëve ishte edhe Marianthi Marko Panariti, 43-vjeçarja që u bë simbol i sakrificës së gruas korçare në luftën antifashiste. Gjaku i saj u derdh mbi kalldrëmet e qytetit që ajo aq shumë e deshi. E plagosur rëndë, dha shpirt në duart e vajzave të saj, të cilat ndodheshin pranë saj në demonstratë. Ishte një fund tragjik për një grua që kishte zgjedhur të mos qëndronte mënjanë, por të bëhej pjesë e luftës për lirinë e atdheut.

Nga një familje atdhetare, te qëndresa antifashiste

Marianthi lindi në Korçë në vitin 1900. Ajo rridhte nga një familje qytetare me tradita atdhetare, ku dashuria për vendin, ndershmëria në punë dhe respekti për njerëzit përbënin vlera të trashëguara ndër breza. Babai i saj, Marko Marko, ishte me origjinë nga fshati Polenë. Ai u rrit në një mjedis ku ndjenjat patriotike dhe lidhja me vendin zinin një vend të rëndësishëm. Që në rini u dallua për karakterin e tij dhe për përkushtimin ndaj punës. Markoja ishte mjeshtër në skalitjen dhe përpunimin e gurit. Me duart e tij punëtore siguroi jetesën e familjes dhe kontribuoi në ndërtimin e qytetit të Korçës, duke lënë gjurmë të punës së tij në mjedisin ku jetoi e veproi. Ai përfaqësonte atë shtresë qytetare që, përmes mjeshtërisë, përpjekjeve dhe ndjenjave atdhetare, ndihmoi në zhvillimin e jetës së qytetit.

Bindjet antifashiste të familjes u vunë në provë që në fillim të pushtimit italian, më 1939. Shtëpia e familjes u bombardua nga fashistët dhe nga sulmi mbeti i plagosur në këmbë vëllai i Marianthit, Spiro Marko. Jeta e tij u vu në rrezik, por ai mundi të mbijetonte falë kujdesit mjekësor. Ky sulm la gjurmë të thella në jetën e familjes dhe dëshmoi se qëndresa ndaj pushtuesit nuk ishte për Marianthin një zgjedhje e shkëputur nga jeta e saj, por një qëndrim i lidhur ngushtë me përvojën dhe vuajtjet e njerëzve të afërt.

Edhe nëna e saj, me origjinë nga fshati Vithkuq, ndikoi në formimin e karakterit të Marianthit. Grua me vullnet të fortë dhe duararta, ajo merrej me endjen e pëlhurave dhe përpunimin e leshit, punë tradicionale të grave korçare, përmes të cilave sigurohej një pjesë e mirë e jetesës familjare. Nga prindërit, Marianthi trashëgoi dashurinë për punën, qëndrueshmërinë përballë vështirësive dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj familjes e atdheut. Ajo ishte motra e katër vëllezërve dhe u rrit në një mjedis ku puna, solidariteti dhe lidhjet familjare kishin rëndësi të veçantë.

Nëna që u bë luftëtare për lirinë

Marianthi u martua me J. Panaritin dhe krijoi familjen e saj, duke lindur e rritur katër vajza. Përkushtimi ndaj fëmijëve ishte një nga shtyllat e jetës së saj. Ajo i edukoi me dashuri për Korçën, respekt për njerëzit dhe ndjenja atdhetare. Por Marianthi nuk e kufizoi veprimtarinë e saj vetëm brenda mureve të shtëpisë. Në kushtet e pushtimit fashist, ajo u angazhua në lëvizjen antifashiste, mori pjesë në demonstratat që zhvilloheshin në qytet dhe, sipas materialit biografik, ishte veprimtare e rinisë antifashiste dhe anëtare e një njësiti gueril.

Ajo ishte ndër ato gra që e kuptuan se liria kërkonte guxim, angazhim dhe sakrificë. Pjesëmarrja e saj në veprimtarinë antifashiste nuk ishte një gjest i rastësishëm, por shprehje e bindjeve të saj dhe e dëshirës për të parë Shqipërinë të çliruar nga pushtuesit. Në ditët e demonstratës, Marianthi doli në rrugët e Korçës së bashku me vajzat e saj. Ajo iu bashkua turmës së demonstruesve dhe shoqeve të saj, mes brohoritjeve dhe këngëve atdhetare. Në atë çast, shpresa për liri dhe besimi te fitorja bashkonin qytetarët, të cilët kërkonin t'i jepnin fund pushtimit.

Askush nuk mund ta dinte se ajo dalje do të shënonte ndarjen e saj të fundit nga jeta. Kur fashistët hapën zjarr mbi demonstruesit, rrugët u mbushën me britma, panik dhe dhimbje. Përpara rrezikut që kërcënonte vajzat e saj, Marianthi reagoi si nënë: i mbuloi me trupin e vet, duke u përpjekur t'i mbronte nga breshëria e plumbave. Por një plumb e goditi dhe ia ndërpreu jetën.

Në çastet e fundit, pranë saj ishin vajzat e saj, të cilat e panë nënën të plagosej rëndë. Sakrifica e Marianthit merr kështu një domethënie të dyfishtë: ajo ra si veprimtare antifashiste në luftën për lirinë e atdheut dhe si nënë që, deri në frymën e fundit, u përpoq të mbronte fëmijët e saj. Në historinë e saj bashkohen dhimbja e një familjeje dhe tragjedia e një qyteti, por edhe një mesazh i fuqishëm për guximin e grave shqiptare, të cilat nuk u tërhoqën përballë dhunës së pushtuesve.

Sakrifica që u bë trashëgimi familjare

Vrasja e Marianthit dhe e demonstruesve të tjerë shkaktoi dhimbje të thellë në Korçë. Megjithëse terrori vazhdonte, qytetarët e përcollën me nderime kujtimin e të rënëve. Tragjedia nuk e shoi vullnetin e tyre për liri; përkundrazi, e forcoi më tej vendosmërinë për të vazhduar luftën kundër pushtuesve. Sipas të dhënave biografike, pas vdekjes së Marianthit, dy prej vajzave të saj dolën partizane në mal, duke vijuar luftën kundër pushtuesve. Kështu, ideali për të cilin kishte luftuar e ëma u bë pjesë e drejtpërdrejtë e jetës së bijave të saj. Sakrifica e saj nuk mbeti vetëm një kujtim i dhimbshëm familjar, por u shndërrua në një trashëgimi që vazhdoi përmes brezit të ri.

Edhe pas çlirimit të vendit, familjarët e saj kontribuuan në jetën dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Vajza e madhe, Dhimitra, u martua në Elbasan me Aleko Karolin. Djali i saj ishte gjeneral Kostaq Karoli, një nga figurat e ushtrisë shqiptare, i cili u nda nga jeta pak muaj përpara hartimit të këtij shkrimi. Kjo vazhdimësi familjare dëshmon se kujtimi i Marianthit nuk lidhet vetëm me çastin e rënies së saj, por edhe me jetën e brezave që erdhën pas, me punën, përkushtimin dhe përgjegjësinë e tyre ndaj shoqërisë.

Dëshmore e Atdheut, përjetësisht në kujtesën e Korçës

Për kontributin dhe sakrificën e saj, Marianthi Panariti është shpallur "Dëshmore e Atdheut" me vendimin nr. 18, datë 25 shkurt 1978. Eshtrat e saj prehen në Varrezat e Dëshmorëve të qytetit të Korçës, aty ku kujtimi i saj është pjesë e historisë së qëndresës dhe e nderimit për ata që dhanë jetën për lirinë e vendit.

Emri i Marianthi Panaritit meriton të kujtohet jo vetëm në përvjetorët e demonstratës antifashiste të Korçës, por edhe në veprimtaritë përkujtimore kushtuar grave që u përfshinë në luftën çlirimtare. Historia e saj na kujton se, në ditët më të vështira të kombit, edhe një nënë e katër vajzave mund të bëhet simbol i një qëndrese që tejkalon kufijtë e jetës individuale. Ajo nuk pati mundësinë të shihte Shqipërinë e çliruar, as të gëzonte jetën e vajzave të saj në një vend pa pushtues. Por la pas një amanet të pashkruar: dashurinë për atdheun, guximin për të mbrojtur lirinë dhe detyrimin moral për të mos harruar ata që u flijuan për të.

Ky kujtim shoqërohet me një zotim të qartë: të mbrojnë me dinjitet kujtimin e dëshmorëve, të nderojnë sakrificat e tyre dhe të jenë të pranishëm në veprimtaritë e Organizatës së Dëshmorëve në Korçë. Bashkë me anëtarësinë e Organizatës, synojnë të ruajnë e të përcjellin te brezat e rinj vlerat e qëndresës antifashiste dhe të sakrificës për atdheun.

Marianthi Panariti mbetet në kujtesën e Korçës si gruaja që doli në rrugë për lirinë, si nëna që u përpoq të mbronte vajzat me trupin e saj dhe si dëshmorja që la pas një histori dhimbjeje, guximi e krenarie. Plumbat ia ndërprenë jetën, por nuk mundën ta shuajnë mesazhin e saj. Ai jeton në kujtesën e familjes, në historinë e qytetit dhe në ndërgjegjen e brezave që e kuptojnë se liria nuk është një dhuratë e përjetshme, por një vlerë e fituar me sakrifica, të cilat kemi detyrimin t'i kujtojmë e t'i nderojmë.

KUR HISTORIA SHKRUHET EDHE ME DUART, SAKRIFICËN DHE GUXIMIN E GRAVE

Nga Mamicë Kastrioti te Nora e Kelmendit, nga Tringë Smajli Martini te Shote Galica - Një histori shqiptare ku gruaja nuk ishte vetëm dëshmitare, por edhe luftëtare, mbrojtëse dhe bartëse e dinjitetit kombëtar

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Fjalori i gjuhës shqipe me ngjyrat e tij të jashtëzakonshme ka fjalë që duken të buta, por brenda tyre mbajnë një forcë të jashtëzakonshme.

Njëra prej tyre është fjala **Grua**.

Në historinë e kombeve, gruaja është parë shpesh duke mbajtur fëmijën në krahë, duke pritur burrin që kthehet nga lufta, duke ruajtur shtëpinë, duke rritur brezat, duke qarë të vrarët dhe duke heshtur për dhimbjet e veta.

Por historia shqiptare ka një tjetër faqe. Një faqe ku gruaja nuk është vetëm ajo që pret. Është edhe ajo që **niset**. Nuk është vetëm ajo që qan. Është edhe ajo që **lufton**.

Nuk është vetëm ajo që mbron vatrën. Është edhe ajo që del përpara saj kur rrezikohet nderi, liria dhe vendi. Kjo është historia e grave shqiptare.

Një histori e shkruar jo gjithmonë me bojë dhe letër, por me sakrificë, qëndresë, besë dhe guxim.

Dhe ndoshta fotografia që kemi përpara është një mënyrë e bukur për të hapur këtë bisedë. Në të shfaqen figura grash të paraqitura me armë, me veshje tradicionale, me uniformë, me shpata dhe me atë shikim të fortë që duket sikur sfidon shekujt.

Ato nuk janë thjesht portrete.

Janë një metaforë.

Metafora e një gruaje që nuk pranoi të ishte e padukshme në historinë e vendit të saj.



MAMICË KASTRIOTI, GRUAJA NË HIJEN E NJË EPOKE TË MADHE

Kur flasim për epokën e Kastriotëve, mendja shkon menjëherë te Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, te betejat, Kruja, qëndresa dhe përplasja me Perandorinë Osmane.

Por pas figurave të mëdha të historisë qëndrojnë gjithmonë edhe njerëz të tjerë.

Dhe mes tyre janë gratë. **Mamicë Kastrioti,** motra e Skënderbeut, i përket një kohe kur gruaja shqiptare jetonte në një shoqëri ku përgjegjësitë familjare, politike dhe shoqërore ishin të ndërthurura. Ajo është pjesë e kujtesës së një familjeje që u kthye në simbol të qëndresës shqiptare.

Historia shpesh i vendos gratë në anën e dytë të fotografisë.

Por kjo nuk do të thotë se ato ishin në anën e dytë të ngjarjeve. Shpesh ato ishin aty ku merreshin vendime, aty ku ruhej familja, aty ku përcillej trashëgimia dhe aty ku mbijetonte ideja e qëndresës.

Të jesh grua në një epokë të tillë nuk ishte thjesht një status familjar.

Ishte një përgjegjësi. Dhe Mamicë Kastrioti mbetet pjesë e asaj trashëgimie që na kujton se historia e familjes Kastrioti nuk mund të kuptohet vetëm përmes figurës së Skënderbeut.

Pas çdo burri që hyn në histori, ka shpesh një botë njerëzish që e kanë mbështetur, edukuar, këshilluar dhe mbajtur gjallë në kohët më të vështira.

NORA E KELMENDIT, KUR NDERI BËHET ARMË

Në historinë e shqiptarëve të Veriut, figura e **Norës së Kelmendit** është shndërruar në një prej simboleve më të fuqishme të gruas luftëtare. Ajo është pjesë e traditës së Kelmendit, një trevë ku liria, besa dhe nderi kanë qenë për shekuj vlera themelore të jetës shoqërore.

Figura e Norës është ndërtuar në kufirin mes historisë dhe legjendës, por pikërisht aty qëndron edhe fuqia e saj simbolike. Sepse popujt nuk ruajnë vetëm dokumentet. Ruajnë edhe kujtesën. Ruajnë historitë që kalojnë nga gjyshi te nipi, nga nëna te vajza, nga një brez te tjetri. Nora u bë simbol i gruas që nuk pranon poshtërimin. Në rrëfimet për të, gruaja nuk shfaqet si viktimë e historisë, por si subjekt i saj. Dhe ky është një ndryshim i madh.

Sepse për shumë shekuj, në kulturat e ndryshme të botës, gratë janë përshkruar kryesisht si viktima të luftërave të burrave.

Në kujtesën shqiptare ekziston edhe një tjetër figurë: Gruaja që merr armën, Gruaja që mbron familjen, Gruaja që mbron vendin, Gruaja që, kur gjithçka tjetër duket se është humbur, zgjedh të mos dorëzohet.

TRINGË SMAJLI MARTINI, NJË GRUA ME PUSHKË NË KRAH DHE SHQIPËRINË NË ZEMËR

Nëse do të kërkonim një figurë që e përmbledh në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhjen mes gruas shqiptare dhe qëndresës, emri i **Tringë Smajli Martinit**, e njohur edhe si Tringë Smajli, do të ishte ndër të parët që do të na vinte në mendje.

Ajo i përket asaj tradite të grave të Malësisë që nuk qëndruan jashtë përplasjeve historike. Përkundrazi. Hynë në to.

Tringë Smajli është kujtuar si një luftëtare e guximshme e kryengritjeve shqiptare në Malësi.

Në një shoqëri ku armët, lufta dhe mbrojtja e vendit ishin zakonisht hapësira të burrave, ajo mori një vend të saj. Dhe kjo është ndoshta arsyeja pse figura e saj ka mbetur kaq e fortë në kujtesën kombëtare.

Sepse ajo sfidoi jo vetëm armikun. Sfidoi edhe një mentalitet.

Dëshmoi se guximi nuk ka gjini. Se dashuria për vendin nuk është privilegj i burrave. Se nderi nuk mbron vetëm shtëpinë e burrit, por edhe zemrën e gruas.

Tringë Smajli nuk është thjesht një emër i një periudhe të largët. Ajo është një pyetje që historia i bën shoqërisë shqiptare edhe sot: Sa herë e kemi parë gruan si forcë dhe jo thjesht si sakrificë?

SHOTE GALICA, GRUAJA QË E BËRI QËNDRESËN NJË MËNYRË JETE

Dhe pastaj vjen **Shote Galica**. Një emër që nuk ka nevojë për shumë shpjegime.

Një grua që e lidhi jetën e saj me një prej periudhave më të vështira të historisë shqiptare. Shote Galica është simbol i qëndresës shqiptare në Kosovë dhe i luftës kundër pushtimeve e padrejtësive të kohës. Ajo nuk ishte një grua që u gjend rastësisht në histori. Ajo zgjodhi të bëhej pjesë e saj.

Me armë në dorë, me jetën e saj në rrezik dhe me një bindje të fortë se liria kishte një çmim. Ajo e pagoi atë çmim.

Shote Galica është një nga ato gra që e ndryshojnë mënyrën se si e lexojmë historinë.

Sepse pas figurës së saj nuk qëndron vetëm luftëtarja. Qëndron edhe gruaja. Gruaja që humbi njerëz të dashur. Gruaja që përjetoi dhimbje.

Gruaja që jetoi në kushte të vështira.

Gruaja që, megjithatë, nuk e lejoi dhimbjen ta kthente në dorëzim. Kjo është ndoshta forma më e madhe e forcës njerëzore: të vuash dhe të mos thyhesh.

Shote Galica e bëri këtë.

Prandaj ajo nuk është vetëm pjesë e historisë së luftës. Është pjesë e historisë së dinjitetit.

GRUAJA SHQIPTARE NUK KA QENË KURRË VETËM "PAS BURRIT"

Ndoshta një nga gabimet më të mëdha që kemi bërë në mënyrën se si e kemi treguar historinë ka qenë se shpesh e kemi ndarë atë në histori burrash dhe histori grash.

Por historia nuk ndahet kështu.

Historia është një.

Dhe në të, burrat dhe gratë kanë jetuar, kanë luftuar, kanë dashur, kanë vuajtur dhe kanë ndërtuar.

Gruaja shqiptare ka qenë në familje, por ka qenë edhe në mal. Ka qenë në shtëpi, por ka qenë edhe në front. Ka qenë nënë, bashkëshorte, motër e bijë, por ka qenë edhe luftëtare, mësuese, intelektuale, veprimtare dhe udhëheqëse. Ajo ka mbajtur mbi shpinë fëmijën dhe në dorë pushkën. Ka gatuar bukën për luftëtarin dhe ka luftuar vetë. Ka qarë të rënët dhe më pas ka vazhduar jetën.

Dhe kjo është arsyeja pse fjala "grua" në historinë shqiptare nuk mund të përkthehet vetëm me fjalën "sakrificë".

Duhet përkthyer edhe me: guxim, qëndresë, dinjitet, besë, forcë, dashuri për vendin.

NGA PUSHKA TE UNIFORMA

Historia e gruas shqiptare nuk përfundon me gratë e shekujve të kaluar.

Ajo vazhdon. Sot gruaja shqiptare nuk ka nevojë të marrë pushkën në mal për të dëshmuar forcën e saj.

Ajo vesh uniformën, shërben në Forcat e Armatosura, është oficere, nënoficere, ushtarake, mjeke, inxhiniere, specialiste, pilote, pjesëtare e strukturave të sigurisë. Ajo komandon, planifikon, udhëheq dhe merr përgjegjësi.

Në uniformë, gruaja nuk humbet feminitetin.

Përkundrazi.

Ajo i shton atij një dimension tjetër: **përgjegjësinë.**

Sepse uniforma nuk pyet nëse je burrë apo grua.

Uniforma pyet: A je e përgatitur? A je e disiplinuar? A mund të mbash përgjegjësinë? A mund të qëndrosh kur të tjerët lëkunden? A mund t'i shërbesh vendit?

Dhe gruaja shqiptare i është përgjigjur kësaj pyetjeje me vepra.

Kjo është arsyeja pse faqet e historisë ushtarake shqiptare nuk mund të shkruhen më pa zërin dhe figurën e grave.

TË JESH GRUA...

Të jesh grua nuk do të thotë të jesh e brishtë.
Do të thotë të dish të jesh e fortë pa humbur butësinë.
Do të thotë të dish të luftosh pa humbur njerëzoren.
Do të thotë të dish të mbrosh pa urryer.
Të dish të udhëheqësh pa e humbur përulësinë.
Të dish të sakrifikosh, por edhe të kërkosh të drejtën për të qenë e barabartë.
Nga Mamicë Kastrioti te Nora e Kelmendit.
Nga Tringë Smajli te Shote Galica.
Nga gratë e Malësisë te gratë e Ushtrisë së sotme.
Shekujt kanë ndryshuar.
Armët kanë ndryshuar.
Uniformat kanë ndryshuar.
Shoqëria ka ndryshuar.
Por një gjë ka mbetur:
gruaja shqiptare nuk ka pranuar të jetë spektatore e historisë së saj.
Ajo ka qenë aty.
Në ditët e mira.
Në ditët e këqija.
Në fitore.
Në humbje.
Në paqe.
Në luftë.
Në shtëpi.
Në shesh.
Në mal.
Në uniformë.

Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse, kur shohim sot portretet e këtyre grave, nuk duhet të shohim vetëm të kaluarën. Duhet të shohim edhe të ardhmen.

Sepse vajza që sot hyn në një akademi ushtarake, që vesh uniformën për herë të parë, që ngjitet në një avion, që merr komandën e një njësie, që shërben në një mision apo që qëndron përballë një përgjegjësie të vështirë, është pjesë e së njëjtës histori.

Ajo nuk është një përjashtim.

Është vazhdim.

Vazhdim i një tradite ku gruaja shqiptare ka ditur të jetë nënë dhe luftëtare, e butë dhe e fortë, mbrojtëse dhe udhëheqëse.

Prandaj titulli i kësaj faqeje nuk është thjesht një fjali.

"Të jesh grua..."
Është një histori.
Një përgjegjësi.
Një trashëgimi.

Dhe mbi të gjitha, një dëshmi se historia e Shqipërisë nuk është shkruar vetëm nga ata që kanë mbajtur shpatën apo pushkën në dorë.

Është shkruar edhe nga gratë që, në çdo epokë, kanë ditur të mbajnë në duar diçka shumë më të madhe: nderin e familjes, dinjitetin e vet dhe dashurinë për vendin.

Dhe kjo është arsyeja pse emrat e tyre nuk duhet të mbeten vetëm në fotografi.

Duhet të jetojnë në kujtesë. Të mësohen në shkolla. Të tregohen brez pas brezi.

Dhe mbi të gjitha, të bëhen frymëzim për vajzat shqiptare të sotme.

Sepse një komb që harron gratë e veta të guximshme, harron një pjesë të vetes.

Ndërsa një komb që i kujton ato, u thotë vajzave të tij: Ju keni ardhur nga një histori e gjatë.

Dhe historia juaj nuk ka mbaruar.

NATO - SIMPOZIUMI I BUKURESHTIT

Bukureshti në qendër të debatit mbi kërcënimet hibride



Bukureshti u bë qendra e debatit ndërkombëtar mbi sigurinë dhe mbrojtjen ndaj kërcënimeve hibride. Aleatët e NATO-s, partnerët, Bashkimi Europian dhe përfaqësues të industrisë u mblodhën në Simpoziumin vjetor të NATO-s për Kërcënimet Hibride, për të diskutuar mbi intensifikimin e aktiviteteve armiqësore të Rusisë dhe mënyrat për të forcuar përgjigjen e përbashkët.

Çfarë janë kërcënimet hibride?

Kërcënimet hibride përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh që kombinojnë mjete ushtarake dhe jo-ushtarake, duke synuar destabilizimin e shteteve pa shpallur një luftë të hapur. Ato mund të shfaqen në disa forma:

Sulmet kibernetike ndaj institucioneve shtetërore dhe kompanive strategjike

Ato synojnë të paralizojnë funksionimin e institucioneve shtetërore, të vjedhin të dhëna të ndjeshme dhe të dëmtojnë kompanitë strategjike që kanë rol kyç në ekonomi dhe siguri kombëtare. Përmes viruseve, ransomware apo ndërhyrjeve në sisteme, aktorët armiqësorë mund të shkaktojnë kaos administrativ, humbje financiare dhe të minojnë besimin e qytetarëve tek shteti. NATO ka paralajmëruar se këto sulme nuk janë thjesht akte kriminale, por pjesë e një strategjie të gjerë për destabilizim politik dhe ekonomik.

Sabotimet fizike ndaj infrastrukturës kritike

Përveç sulmeve digjitale, lufta hibride përfshin edhe sabotime fizike. Objektivat kryesorë janë rrjetet energjetike, sistemet e transportit dhe infrastruktura e ujit apo telekomunikacionit. Një ndërprerje e energjisë elektrike, për shembull, mund të paralizojë një qytet të tërë, duke krijuar panik dhe duke dobësuar aftësinë e shtetit për të reaguar. Sabotimet e tilla shpesh kryhen në mënyrë të fshehtë, përmes infiltrimit të grupeve të organizuara ose përdorimit të mjeteve të vogla, por me efekt të madh. Këto akte e vendosin sigurinë kombëtare në rrezik dhe kërkojnë një koordinim të ngushtë mes institucioneve shtetërore dhe sektorit privat për mbrojtje.

Dezinformimi dhe propaganda

Një tjetër armë e fuqishme e luftës hibride është manipulimi i informacionit. Përmes fushatave të dezinformimit, propagandës dhe lajmeve të rreme, synohet të ndikohet opinioni publik, të krijohet përçarje sociale dhe të dobësohet besimi tek institucionet demokratike. Këto fushata shpesh shfrytëzojnë rrjetet sociale, duke përhapur narrativa të rreme që synojnë të nxisin pasiguri, frikë apo mosbesim. NATO e konsideron këtë një kërcënim serioz, pasi propaganda e vazhdueshme mund të ndikojë në vendimmarrjen politike dhe të minojë unitetin e Aleancës. Për këtë arsye, lufta kundër dezinformimit është bërë një prioritet strategjik.

Incidente me dronë dhe operacione të fshehta

Përdorimi i droneve është një tjetër element i luftës hibride. Ata mund të përdoren për survejim, për sulme të vogla, apo për të testuar mbrojtjen e vendeve të synuara. Incidente të tilla janë rritur ndjeshëm, duke treguar se dronët janë bërë një mjet i lirë dhe efektiv për destabilizim rajonal. Përveç dronëve, operacionet e fshehta – si infiltrimi i agjentëve, mbështetja e grupeve ekstremiste apo veprimet e fshehta ekonomike – synojnë të dobësojnë shtetet pa e shpallur hapur konfliktin. Këto veprime e bëjnë luftën hibride të vështirë për t'u identifikuar dhe për t'u kundërshtuar, pasi shpesh nuk ka prova të drejtpërdrejta që lidhen me aktorin armiqësor.

Kjo lloj lufte hibride është e vështirë për t'u identifikuar dhe shpesh operon në "zonën gri" mes paqes dhe konfliktit të hapur, duke e bërë reagimin e koordinuar ndërkombëtar jetik. Kërcënimet hibride janë shumëdimensionale dhe synojnë të godasin shtetet në pika të dobëta, duke kombinuar teknologjinë, propagandën dhe veprimet e fshehta.

Simpoziumi i Bukureshtit tregoi se NATO është e vetëdijshme për këtë realitet dhe po punon për të forcuar mbrojtjen, rezistencën dhe koordinimin ndërkombëtar. Mesazhi kryesor mbetet i qartë: pavarësisht formave të ndryshme të luftës hibride, Aleanca është e bashkuar dhe e vendosur për të mbrojtur sigurinë dhe stabilitetin e saj.

Simpoziumi i Bukureshtit, një përgjigje e përbashkët

Diskutimet në Bukuresht u përqendruan tek mbrojtja e infrastrukturës kritike, veçanërisht në sektorin energjetik, i cili është një objektiv i përsëritur i sulmeve hibride. Pjesëmarrësit ndanë përvoja nga incidentet e fundit dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin privat, pasi kompanitë energjetike dhe teknologjike janë shpesh në vijën e parë të këtyre sulmeve.

Në fjalën e tij hapëse, Jean Charles Ellermann-Kingombe, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, theksoi se Aleanca ka mjetet dhe vendosmërinë për të kundërshtuar kërcënimet hibride. Ai nënvizoi se veprimet e Rusisë nuk do të dobësojnë unitetin e NATO-s, as mbështetjen e saj për Ukrainën.

Përvoja rajonale dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Përvoja rajonale dhe bashkëpunimi ndërkombëtar ishin një nga shtyllat kryesore të Simpoziumit të Bukureshtit. Përfaqësuesit e Bashkimit Europian sollën perspektivën e tyre mbi koordinimin politik dhe institucional, duke theksuar rëndësinë e mekanizmave të posaçëm për luftën kundër dezinformimit, mbrojtjen e rrjeteve energjetike dhe forcimin e sigurisë kibernetike. Përvoja e BE-së është e vlefshme sepse tregon se si një bashkësi e gjerë shtetesh mund të harmonizojë politikat e sigurisë dhe të krijojë një front të përbashkët kundër kërcënimeve hibride, duke shmangur fragmentimin dhe duke siguruar që çdo vend anëtar të mos mbetet i ekspozuar.

Ukraina, e cila prej vitesh është nën presionin e sulmeve hibride, solli shembuj konkretë mbi mënyrat e mbrojtjes dhe rezistencës. Nga sulmet kibernetike ndaj institucioneve shtetërore, deri tek sabotimet e infrastrukturës energjetike dhe fushatat e dezinformimit, Ukraina ka përjetuar të gjitha format e kësaj lufte. Përvoja e saj është e paçmueshme për Aleancën, pasi ofron mësime konkrete mbi rikuperimin pas sulmeve dhe mbi mobilizimin e shoqërisë për të ruajtur kohezionin kombëtar. Ukraina ka treguar se rezistenca nuk është vetëm teknike, por edhe shoqërore, duke përfshirë qytetarët, mediat dhe institucionet në një përpjekje të përbashkët.

Moldavia, një vend më i vogël dhe i ndjeshëm ndaj ndikimit rus, ndau përvoja mbi forcimin e kapaciteteve të sigurisë dhe bashkëpunimin rajonal. Për Moldavinë, bashkëpunimi me NATO-n dhe BE-në është një garanci sigurie, duke treguar se edhe vendet me kapacitete më të kufizuara mund të jenë pjesë e një sistemi më të madh mbrojtjeje. Përvoja e saj tregon se kërcënimet hibride nuk godasin vetëm vendet e mëdha, por mund të destabilizojnë edhe shtete më të vogla, duke i bërë ato të varura nga solidariteti dhe mbështetja ndërkombëtare.

Ndarja e përvojave mes BE-së, Ukrainës dhe Moldavisë tregoi se kërcënimet hibride nuk njohin kufij dhe mund të godasin çdo vend, pavarësisht madhësisë apo fuqisë ekonomike. Prandaj, bashkëpunimi ndërkombëtar është i domosdoshëm për të ndërtuar një rezistencë kolektive. NATO e sheh këtë si një element kyç: vetëm përmes koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe solidaritetit mund të përballohen kërcënimet që operojnë në "zonën gri" mes paqes dhe konfliktit. Përvoja rajonale e Ukrainës dhe Moldavisë, e kombinuar me kapacitetet e Bashkimit Europian, krijon një bazë të fortë për veprim të përbashkët dhe e bën Simpoziumin e Bukureshtit një moment të rëndësishëm në përpjekjet e Aleancës për të forcuar sigurinë dhe stabilitetin.

Rëndësia strategjike e simpoziumit

Ky aktivitet, i bashkëorganizuar nga Divizioni i NATO-s për Transformimin Kibernetik dhe Digjital dhe Ministria e Jashtme e Rumanisë, me mbështetjen e Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit të Inteligjencës Rumun, është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të NATO-s për të rritur rezistencën e vendeve anëtare ndaj sulmeve hibride, forcuar gatishmërinë për t'u përballur me incidente të papritura dhe për të siguruar parandalim dhe mbrojtje efektive përballë kërcënimeve të reja.

Lufta hibride si sfidë e shekullit XXI

Lufta hibride është bërë një nga sfidat kryesore të sigurisë globale. Ajo nuk synon vetëm të dëmtojë infrastrukturën, por edhe të minojë besimin e qytetarëve tek institucionet demokratike dhe të krijojë pasiguri politike e ekonomike. Për këtë arsye, uniteti dhe koordinimi ndërkombëtar janë thelbësorë.

Simpoziumi i Bukureshtit tregoi qartë se NATO dhe partnerët e saj janë të vendosur të mos lejojnë që kërcënimet hibride të minojnë sigurinë dhe stabilitetin e Aleancës. Mesazhi kryesor ishte i qartë: pavarësisht intensifikimit të aktiviteteve armiqësore të Rusisë, Aleanca mbetet e bashkuar, e përgatitur dhe e vendosur për të mbrojtur vlerat dhe sigurinë e saj.

Në realitetin e sotëm, ku kufijtë mes paqes dhe konfliktit janë gjithnjë e më të paqartë, lufta hibride është shndërruar në një nga sfidat më të mëdha të sigurisë globale. Ajo nuk kufizohet vetëm në dëmtimin e infrastrukturës kritike, por synon të prekë themelet e shoqërive demokratike duke minuar besimin e qytetarëve tek institucionet, duke krijuar pasiguri politike dhe duke destabilizuar ekonomitë. Kërcënimet hibride janë të sofistikuara sepse kombinojnë elementë të dukshëm dhe të padukshëm, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre dhe duke e vendosur shtetet përballë një lufte që nuk shpallet kurrë hapur, por që ndjehet në çdo aspekt të jetës publike.

Në këtë kontekst, uniteti dhe koordinimi ndërkombëtar janë të domosdoshëm. Asnjë vend nuk mund të përballet i vetëm me një strategji që synon të shfrytëzojë dobësitë e brendshme dhe të krijojë përçarje. Vetëm përmes solidaritetit, shkëmbimit të informacionit dhe veprimit të përbashkët mund të ndërtohet një rezistencë efektive ndaj këtyre kërcënimeve. Simpoziumi i Bukureshtit e bëri të qartë se NATO dhe partnerët e saj nuk janë të gatshëm të lejojnë që kërcënimet hibride të minojnë sigurinë dhe stabilitetin e Aleancës. Mesazhi i dërguar ishte i fortë: pavarësisht intensifikimit të aktiviteteve armiqësore të Rusisë, Aleanca mbetet e bashkuar, e përgatitur dhe e vendosur për të mbrojtur vlerat e saj, për të ruajtur stabilitetin dhe për të garantuar sigurinë e qytetarëve të saj.

Ky qëndrim i qartë është një sinjal i rëndësishëm jo vetëm për Aleatët, por edhe për kundërshtarët e NATO-s. Ai tregon se, edhe pse lufta hibride është një sfidë e shekullit XXI, ajo nuk do të arrijë të thyejë kohezionin e Aleancës. Përkundrazi, kërcënimet e reja po e shtyjnë NATO-n drejt një bashkëpunimi më të ngushtë, një përgatitjeje më të avancuar dhe një vendosmërie më të madhe për të mbrojtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.



Franca kryen testin e parë të raketës balistike M51.3 pas tre vitesh

Një provë e rëndësishme për fuqinë bërthamore franceze

Franca kreu testin e saj të parë në tre vjet të një rakete balistike të lëshuar nga nëndetësja, duke përdorur nëndetësen bërthamore "Le Vigilant". Ky test u zhvillua mbi Oqeanin Atlantik dhe kishte një rëndësi të veçantë, pasi për herë të parë u provua varianti më i ri i raketës strategjike franceze, M51.3, i cili kishte hyrë në shërbim operacional në tetor 2025. Testi ishte pjesë e ciklit të rregullt që Franca kryen për të verifikuar besueshmërinë e sistemit të saj të deterrencës bërthamore. Ministrja e Mbrojtjes e Francës (ministrja e Forcave të Armatosura), Catherine Vautrin, e cilësoi operacionin si një sukses të planifikuar prej kohësh, që mishëron vizionin e presidentit Macron për të ruajtur besueshmërinë e forcave bërthamore sipas kornizës së LPM 2024-2030.

Detajet e lëshimit dhe kufizimet e vendosura në Atlantik

Raketa M51.3 përshkoi një trajektore prej rreth 4,700 kilometrash, më e vogël se rrezja maksimale e vlerësuar e sistemit. Ajo u lëshua pa kokë bërthamore nga ujërat pranë brigjeve të Finistère, ku autoritetet franceze kishin vendosur kufizime për lundrimin deri më 21 tetor. Trajektorja u monitorua nga DGA/*Essais de missiles* dhe nga anija e matjeve "Monge", ndërsa zona e rënies ishte në Atlantikun e Veriut, larg çdo bregu. Ky ishte lëshimi i parë në det i variantit M51.3 që nga hyrja në shërbim, pas provës së parë të kryer në Biscarrosse, në nëntor 2023.

Procesi i gjatë i mirëmbajtjes së nëndetëses "Le Vigilant"

"Le Vigilant" kishte përfunduar një proces të gjerë mirëmbajtjeje (IPER) që nisi në vjeshtën e vitit 2023 në bazën strategjike të nëndetëseve "Île Longue". Ndërhyrjet përfshinë reaktorin bërthamor, sistemet e armëve dhe pajisje të tjera kritike. Pas mirëmbajtjes, nëndetësja kreu prova në det, dhe lëshimi i një rakete M51 ishte një nga testet kryesore për të verifikuar funksionimin e plotë të sistemit.

Krahasimi me testet e mëparshme dhe rëndësia e variantit të ri

Një test i ngjashëm ishte kryer nga nëndetësja "Le Terrible", në prill 2023. Megjithatë, testi aktual kishte rëndësi të veçantë, pasi për herë të parë u provua varianti më i ri operacional i raketës M51.3. Ky model është projektuar për të pasur rreze më të madhe, saktësi më të lartë dhe aftësi të përmirësuara për të depërtuar sistemet e mbrojtjes raketore. ArianeGroup, kontraktori kryesor industrial, konfirmoi se testimi përfshiu eksperimente për zhvillimin e variantit të ardhshëm M51.4, mbi të cilin puna kishte nisur në shtator 2025.

Karakteristikat teknike dhe roli i kokës bërthamore TNO-2

Raketa M51.3 është projektuar për të mbajtur kokën e re bërthamore franceze TNO-2, më të avancuar dhe më të fuqishme se variantet e mëparshme. Ajo ka aftësi të avancuara për të shmangur sistemet e mbrojtjes raketore dhe për të siguruar një nivel më të lartë besueshmërie në misionet strategjike.

Ministrja e Mbrojtjes e Francës (ministrja e Forcave të Armatosura), Catherine Vautrin njoftoi se versioni i tretë i raketës balistike të lëshuar nga nëndetësja M51 (SLBM) e njohur si "M51.3" hyri në shërbim operativ, më 24 tetor 2025. M51.3 do të vendoset në bordin e nëndetëseve me raketa balistike bërthamore (SSBN) të klasit "Le Triomphant" të Marinës Franceze.

E zhvilluar nga ArianeGroup (duke vepruar si kontraktor kryesor) nën mbikëqyrjen e agjencisë franceze të prokurimit dhe teknologjisë së mbrojtjes DGA, raketa M51.3 ofron aftësi të përmirësuara të rrezes, saktësisë dhe depërtimit. Sipas autoriteteve franceze, SLBM e re përforcon besueshmërinë e komponentit oqeanik të pengesës bërthamore të Francës përballë mbrojtjes raketore kundërshtare në zhvillim. Ajo mbart kokën e re bërthamore oqeanike (TNO-2), të projektuar dhe të garantuar përmes programit të Simulimit të Komisionit Francez të Energjisë Atomike (CEA).

"Kjo vendosje operacionale shënon kulmin e programeve M51.3 dhe TNO-2, përkatësisht të kryera dhe të lançuara nga DGA në vitin 2014 dhe nga CEA në vitin 2013. Ekzekutimi i këtyre programeve, i ankoruar në kuadrin afatgjatë të ligjit të planifikimit ushtarak, siguron vazhdimësinë e aftësive tona për këtë mision strategjik", - tha ministria franceze e Mbrojtjes në një njoftim.

Lëshimi i parë provë i një rakete balistike M51 u krye me sukses në Qendrën e Testeve për *Launch de Missile* (CELM) në Biscarosse, Francë, më 9 nëntor 2006. Testi i gjashtë i raketës i kryer më 5 maj 2013 përfundoi me dështim. Testet e fundit të M51 në shtator 2015, korrik 2016, qershor 2020 dhe prill 2021 dhe prill 2023 ishin të gjitha të suksesshme.

Ushtria franceze njoftoi se testoi me sukses një raketë të re balistike të lëshuar nga nëndetëse (SLBM) më 18 nëntor 2023, nga një strukturë testimi në tokë. Ky ishte lëshimi i parë ndonjëherë i SLBM M51.3.

Në shtator 2025, DGA franceze i dha ArianeGroup një kontratë për të projektuar dhe prodhuar versionin e katërt të raketës balistike të lëshuar nga nëndetësja M51 (SLBM) e njohur si "M51.4". Rrezja e veprimit, preciziteti dhe aftësitë depërtuese të përmirësuara të M51.4 do të përforcojnë besueshmërinë e mbrojtjes bërthamore oqeanike të Francës në përgjigje të kërcënimeve në zhvillim.

Dimensioni politik dhe mesazhi ndërkombëtar i testit

Testi i raketës M51.3 nuk ishte vetëm një provë teknike, por edhe një mesazh politik. Presidenti Emmanuel Macron, i pranishëm gjatë lëshimit, e cilësoi suksesin si një demonstrim të besueshmërisë së deterrencës franceze: "Për të qenë i lirë, duhet të jesh i frikshëm. Dhe për të qenë i frikshëm, duhet të jesh i fuqishëm". Ky test u krye në një kohë kur tensionet ndërkombëtare ishin rritur, veçanërisht pas paralajmërimeve të presidentit rus Vladimir Putin mbi mbrojtjen e Kaliningradit me armë bërthamore në rast kërcënimesh. Ngjarja shërbeu si një sinjal për aleatët e NATO-s se Franca mbetet një shtyllë e rëndësishme e mbrojtjes kolektive dhe një aktor kyç në sigurinë europiane.

Reagimet ndërkombëtare dhe ndikimi në sigurinë globale

Testi i M51.3 tërhoqi vëmendjen e fuqive të tjera bërthamore dhe organizatave ndërkombëtare. Aleatët e NATO-s e përshëndetën si një garanci shtesë për mbrojtjen kolektive, ndërsa disa vende jashtë NATO-s shprehën shqetësime për rritjen e tensioneve globale. Ky zhvillim nënvizon dilemat e sigurisë ndërkombëtare: modernizimi i arsenaleve bërthamore rrit besueshmërinë e deterrencës, por njëkohësisht mund të perceptohet si provokim nga rivalët strategjikë. Organizatat për kontrollin e armëve theksuan nevojën për dialog diplomatik dhe transparencë për të shmangur përshkallëzimin e krizave.

Teknologjia franceze dhe roli i industrisë kombëtare

Programi M51.3 është rezultat i bashkëpunimit mes ArianeGroup, DGA dhe industrisë franceze të mbrojtjes. Ky projekt demonstron kapacitetin e Francës për të zhvilluar teknologji të avancuara në mënyrë të pavarur, duke ruajtur kontrollin e plotë mbi mjetet e saj të deterrencës bërthamore. Përveç aspektit ushtarak, programi ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë kombëtare, duke gjeneruar vende pune të specializuara dhe duke rritur prestigjin e Francës si një lider në fushën e teknologjive hapësinore dhe raketore.

Perspektiva e së ardhmes për deterrencën franceze

Me hyrjen në shërbim të raketës M51.3, Franca ka bërë një hap të madh drejt modernizimit të arsenalit të saj strategjik. Testi i "Le Vigilant" konfirmoi aftësitë e sistemit dhe hapi rrugën për përdorimin e tij të plotë në operacione. M51.3 pritet të mbetet një element kyç i deterrencës franceze për dekadat e ardhshme, duke garantuar sigurinë kombëtare dhe rolin e Francës si një fuqi bërthamore e besueshme. Në këtë kuadër, Franca ka planifikuar të rrisë buxhetin e mbrojtjes në 76.3 miliardë euro deri në vitin 2030, duke e çuar shpenzimin në 2.5% të PBB-së, nga rreth 2% aktualisht.

Një hap drejt modernizimit të plotë të arsenalit francez

Testi i raketës M51.3 nga nëndetësja "Le Vigilant" ishte një ngjarje e rëndësishme për forcat detare franceze dhe për politikën e mbrojtjes së vendit. Ai përfaqësoi jo vetëm një provë teknike, por edhe një mesazh strategjik për botën. Me këtë hap, Franca tregoi se është e gatshme të përballojë sfidat e së ardhmes dhe të ruajë statusin e saj si një nga fuqitë kryesore bërthamore në botë. Testi i M51.3 nga Le Vigilant shënoi një moment historik për modernizimin e arsenalit francez, duke konfirmuar besueshmërinë e deterrencës dhe duke dërguar një mesazh të qartë politik e strategjik në skenën ndërkombëtare. Ai përforcoi rolin e Francës si një aktor kyç në sigurinë europiane dhe globale, duke e vendosur vendin në një pozicion të fortë për dekadat e ardhshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Tetori Rozë

NUK ËSHTË THJESHT

NJË FJONGO ROZË



NJË THIRRJE PËR TË GJITHË

Të mos heshtim.
Të mos vonohemi.
Të mos e lëmë gruan vetëm.
Sepse pas çdo numri është një grua.